

Fuqizimi i kujdesit të bazuar në familje, fuqizimi i punës sociale

Një analizë e situatës së
strehimit familjar në Kosovë* (RKSOKB 1244) 2015

Dr. Ian Milligan
(Nëntor 2015)

Parathënie

Përvojat gjatë fëmijërisë kanë ndikim shumë të gjerë në zhvillimin e fëmijës. Përvojat negative në fëmijëri, sidomos braktisja, neglizhimi, abuzimi dhe shfrytëzimi mund të kenë pasoja të mëdha në zhvillimin e fëmijëve. Megjithatë, çdo ditë, në pjesë të ndryshme të botës, fëmijët kalojnë nëpër përvoja negative të fëmijërisë, sidomos fëmijët pa përkujdesje prindërore. Miliona fëmijë në mbarë botën nuk kanë përkujdesje prindërore, ose janë në rrezik ta humbin atë dhe përballen me sfida të mëdha në jetën e tyre të përditshme të cilat shpesh herë kanë ndikim afatgjatë deri vonë në moshë madhore.

Ky raport përfshin të drejtat e fëmijëve më të cenuar në Kosovë¹ për të cilët nuk mund të kujdeset askush nga familja e tyre. Qëllimi i raportit është të rishikohet situata aktuale, dispozitat dhe rrethanat me të cilat përballen këta fëmijë dhe të rinj, si dhe mënyra se si sistemi i mbrojtjes në Kosovë mund të ofrojë mbrojtje dhe përkrahje. Vlerësimi bazohet në parimet kyçe dhe orientimet politike të Udhëzimeve të KB-së për Kujdesin Alternativ të Fëmijëve, të miratuar nga APKB në vitin 2009, duke u fokusuar në rëndësinë e punës parandaluese dhe vendosjes së një sistemi të fuqishëm "sigurimit të portave të sigurta".

Në veçanti, të gjeturat e këtij raporti kanë për synim të kontribuojnë në të siguruarit që mekanizmat efektiv për kujdes alternativ janë të themeluara dhe që fëmijët, përfshirë ata pa përkujdesje prindërore, janë të mbrojtur nga dhuna, abuzimi, shfrytëzimi dhe neglizhenca. Raporti ofron rekomandime për hapat e ardhshëm që mund të ndërmerren nga ministrinë, komunat, OJQ-të dhe partnerët e shoqërisë civile për fuqizimin e kapacitetit dhe funksionimit të shërbimeve të përkujdesit alternativ në mënyrë që familjet të ndihmohen dhe nevojat e fëmijëve të plotësohen si dhe të drejtat e tyre të realizohen.

Një ekip hulumtuesish nga QEFPS, Qendra e Ekselencës për Fëmijët nën Përkujdesje në Skoci, me bazë në Universitetin Strathclyde në Glasgo, në veçanti profesori Ian Milligan e kanë bërë një hulumtim të detajuar për raportin. Do të doja t'i falënderoja hulumtuesit për ndihmën e tyre të çmuar në zhvillimin e këtij raporti, stafin e UNICEF-it nga sektori i Mbrojtjes së Fëmijës për punën e tyre të palodhshme dhe koordinuëse, si dhe të gjithë ata që kaluan kohën e tyre duke i ndihmuar hulumtuesit në kompletimin e këtij raporti.

Do të doja ta falënderoja Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale për udhëheqjen dhe vendosshmërinë në mbështetjen e këtij hulumtimi dhe për punën e palodhshme në zhvillimin dhe fuqizimin e sistemit të kujdesit alternativ në Kosovë për fëmijët pa përkujdesje prindërore. Sigurisht, kjo punë nuk do të realizohej pa mbështetjen e përkushtuar të OJQ-ve dhe partnerëve të tjerë të rëndësishëm, me misionin e përbashkët për avokimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në Kosovë.

Laila Omar Gad



Kryesuese e zyrës së UNICEF-it në Kosovë

1 Të gjitha referencat për Kosovë bëhen në kontekstin e Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB (1999)

Fuqizimi i kujdesit të bazuar në familje, fuqizimi i punës sociale
Një analizë e situatës së strehimit familjar në Kosovë 2015
Dr. Ian Milligan
(Nëntor 2015)

design@XHAD.net

Tabela e Përmbajtjes

Terminologjia dhe akronimet.....	7
Falënderimet	7
<i>Raporti i rishikuar</i>	7
A. Hyrje.....	8
A. 1. Qëllimet e Vlerësimit	8
A.2. Metodologjia e analizës së situatës	9
Burimet	9
B. Konteksti i kujdesit alternativ	10
B. 1. Historiku: Kosova	10
Strategjitë për Strehimin Familjar	13
B. 2. Partneriteti i Institucioneve të Kosovës dhe OJQ-ve në strehimin familjar	13
B. 3. Ndikimi i De-centralizimit në Qendrat për Punë Sociale	14
Buxhetet e QPS-ve	15
Kolegjiumi për Strategjinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale	16
Përfundimi për decentralizimin.....	16
B. 4. Braktisja e foshnjave	17
C. Strehimi familjar në vitin 2015	20
C. 1. Shqyrtim i Përgjithshëm	20
Pagesat për strehuesit familjarë	20
Shpenzimet shëndetësore.....	21
C. 2. Numri i familjeve dhe disponueshmëria	21
C. 3. Rekrutimi	21
C. 4. Menaxhimi i rasteve dhe partneriteti ndërmjet punonjësve social dhe strehuesve familjarë	22
C. 5. Mbështetja nga Amici dei Bambini	23
D. Kujdesi rezidencial (në grup të vogël)	25
SOS	25
CARITAS	25
Shpresa dhe Shtëpitë për Fëmijë në Kosovë	26
E. Largimi nga kujdesi	27
Shërbimet për të larguarit nga kujdesi në Kosovë	27
Zhvillimi i politikave dhe pjesëmarrja	27
F. Sfidat aktuale dhe çështjet kyçe në kujdesin alternativ	29

<i>F. 1. Fëmijët dhe sistemi i kujdesit në Kosovë</i>	29
<i>Përçindja e fëmijëve në kujdesin alternativ</i>	30
<i>F. 2. Fuqizimi i Strehimit familjar</i>	30
<i>F. 2.1. QPS-të dhe strehimi familjar</i>	30
<i>F. 2.2. Një 'Plan B' për fuqizimin e strukturës së QPS-së rreth strehimit familjar</i>	31
<i>F. 2.3. Mbështetja financiare për strehuesit familjarë</i>	32
<i>F. 2.4. Puna në partneritet me punonjësit socialë të QPS-ve</i>	32
<i>F. 2.5. Mbështetja e specializuar për strehuesit familjarë</i>	33
<i>F. 3. Statusi ligjor dhe çështjet e birësimit</i>	33
<i>F. 4. Menaxhimi i përmirësuar i kujdesit për të porsalindurit e braktisur</i>	34
<i>F. 5. Udhëzimi i Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale</i>	36
<i>F. 5.1. Shqyrtimi i Udhëzimit</i>	36
<i>F. 5.2. Standardet Minimale për shërbimet Sociale (strukurore dhe funksionale)</i>	36
G. Rekomandimet	37
<i>G. 1. Lidërshipi</i>	37
<i>G. 2. Mbështetja për strehuesit familjarë</i>	37
<i>G. 3. Udhëzimi i Përditësuar</i>	38
<i>G. 4. QPS-të</i>	38
<i>G. 5. Fokusi në mbështetjen e nënave të rrezikuara, reduktimin e numrit të foshnjave të braktisura dhe përmirësimin e kujdesit</i>	39
<i>G. 6. Përmirësimi i procesit të vendosjes së statusit ligjor të fëmijëve të braktisur</i>	39
<i>G. 7. Veprime për fëmijët e larguar nga kujdesi</i>	39
<i>G. 8. Kujdesi nga Faresi - Cilësia e kujdesit dhe jetës familjare</i>	40
Shtojcat	45

Terminologjia dhe akronimet

AiBi	Amici dei Bambini
AKK	Asociacioni i Komunave të Kosovës
Kolegjiumi	Kolegjiumi për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, AKK
DShMS	Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale (Komunale)
QPS	Qendra për Punë Sociale (në secilën Komunë)
KOMF	Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve
KKBDTF	Konveta e Kombëve të Bashkuara për të Drejta të Fëmijëve
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
QKUK	Qendra Klinike Universitare e Kosovës, Prishtinë (referohet si Spitali i Prishtinës)
APKB	Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara
UKB KAF	Udhëzimet e KB për Kujdesin Alternativ për Fëmijët ('Udhëzimet')
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijë

'Ministria' i referohet Departamentit për Politika Sociale dhe i Familjes (DPS&F) në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, përveç nëse specifikohet ndryshe.

Falënderimet

Dëshiroj të falënderoj të gjithë ata që e ndanë kohën e tyre për t'u takuar me mua dhe për t'iu përgjigjur pyetjeve; zyrtarëve të qeverisë, pjesëtarëve të stafit të OJQ-ve dhe prindërve strehues. Shumë pjesëtarë të stafit në zyrën e UNICEF-it kanë ofruar informacione të dobishme, si dhe gjithë ndihmën praktike dhe mbështetëse që ka ndikuar në përdorimin e mirë të kohës gjatë fazës së punës në terren. Falënderimet e veçanta janë për Feride Dashin dhe Afrim Ibrahim, të cilët e mbikqyrën projektin dhe më ofruan udhëzime të vazhdueshme profesionale, si dhe falënderoj Ilire Perjuci Selimin për të gjitha aranzhimet mbështetëse. Po ashtu i jam mirënjohës mbështetjes së ofruar nga kolegja prej QEFPS Dr.Christine Gale, Udhëheqëse Ndërkombëtare në QEFPS.

Raporti i rishikuar

Ky version i raportit është rishikuar nga origjinali. Origjinali është prezantuar në një "punëtori miratimi" që është mbajtur në Prishtinë më 18 nëntor 2015. Të pranishëm në punëtori ishin personat të cilët unë i kisha intervistuar dhe të tjerë që i përfaqësonin organizatat e tyre.

A. 1. Qëllimet e Vlerësimit

'Kushtet e Referencës' (KeR) për këtë detyrë kanë pasur të bëjnë me vlerësimin e Sistemit të Kujdesit Alternativ në Kosovë, me një fokusim të veçantë në strehimin familjar. Qëllimi përfundimtar i vlerësimit është që të kontribuojë në fuqizimin e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve në Kosovë. Në veçanti, gjetjet kanë për qëllim të kontribuojnë në sigurimin e funksionalizimit të mekanizmave efektiv të kujdesit alternativ dhe që fëmijët, duke i përfshirë edhe ata pa kujdes prindëror, të jenë të mbrojtur nga dhuna, abuzimi, shfrytëzimi dhe neglizhenca. Sistemi duhet gjithashtu të sigurojë që, kur është në interesin më të mirë të fëmijës, çdo vendosje në kujdes alternativ të jetë në një mjedis të sigurt dhe të dashur familjar.

Si përgjigje ndaj KeR, ky raport identifikon boshllëqet në sistemin e kujdesit alternativ, si dhe pengesat dhe dobësitë në funksionimin e planifikimit të kujdesit dhe përdorimin e vendosjeve në kujdesin alternativ. Ai ofron rekomandime për hapat e mëtejshme që mund të ndërmerren nga Ministritë e Qeverisë, komunitat, OJQ-të dhe partnerët e shoqërisë civile për ta fuqizuar kapacitetin dhe funksionimin e shërbimit të kujdesit alternativ në mënyrë që familjet të mbështeten, që nevojat e fëmijëve të përmbushen dhe të drejtat e tyre të realizohen.

Raporti do të jetë me vlerë për të gjithë akterët dhe do të kontribuojë gjithashtu në shqyrtimin e Programit të UNICEF-it për vitet 2011-2015 në Kosovë. 'Kushtet e Referencës' (KeR) për këtë analizë tërthorë vëmendjen e problemit të braktisjes së fëmijëve, si një nga pasojat e 'Ankthit social në lidhje me situatën pas konfliktit dhe mungesën e rrjeteve adekuate të sigurisë'. Sistemi i strehimit familjar, i inicuar dhe i mbështetur nga OJQ-të ndërkombëtare, është duke u zhvilluar në Kosovë që nga përfundimi i konfliktit në vitin 1999, dhe fillimisht është fokusuar kryesisht në foshnje të posalindura të braktisura dhe në fëmijët e vegjël. Megjithatë, madhësia dhe shtrirja e sistemit të strehimit familjar nuk ka përparuar shumë që nga fillimet e tij, edhe pse pagesa për strehim familjar është rritur, familjet strehuese ende kryesisht përkujdesen vetëm për foshnjat. KeR gjithashtu i referohen gjetjeve të një raporti të madh, Hartëzimi dhe Vlerësimi i Sistemit të mbrojtjes së Fëmijëve (UNICEF, 2012), i cili tregoi një mungesë të përgjithshme të opsioneve të kujdesit alternativ dhe një përkushtim të kufizuar për strehimin familjar nga ana e shumë QPS-ve, 'Shërbimi i strehimit familjar ende shihet si një "Projekt i OJQ-ve" dhe qeveria nuk e ka marrë pronësinë e plotë për shkak të mungesës së resurseve teknike, njerëzore dhe financiare'. (KeR).

Ka pasur një numër fushash të rëndësishme të zhvillimit të shërbimeve sociale të ndërmarra nga qeveria dhe OJQ-të gjatë viteve të fundit.

- Ka pasur një proces të madh të decentralizimit – nga Ministria në Komunë në ofrimin e shërbimeve duke i përfshirë edhe shërbimet sociale.
- Janë zhvilluar Standardet Minimale për shërbime Sociale. Këto veprojnë si udhëzime dhe mjete të monitorimit për punën e ndërmarrë nga punonjësit social në Qendrat për Punë Sociale (QPS) të cilat tani gjenden në secilën komunë.
- Një sistem i strehimit familjar, në mbarë Kosovën, kryesisht me qëllimin e ofrimit të shtëpive për foshnjat e braktisura, që është inicuar në vitin 2002 me mbështetjen e OJQ-ve.
- Sfida për t'iu përgjigjur normës së vazhdueshme (edhe pse në ulje) të braktisjes së foshnjave ka qenë fokus i vëmendjes dhe avokimit. Një analizë e detajuar e problemeve në këtë fushë, raporti Take Me Home! (Më dërgo në Shtëpi!) (KOMF, 2014a) është botuar kohëve të fundit nga KOMF (Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve).

- OJQ-të e përfshira në ofrimin dhe mbështetjen e shërbimeve të kujdesit alternativ - "EveryChild", Save the Children, SOS Fshati i Fëmijëve, Amici dei Bambini (AiBi) në Kosovë, Caritas, Hopes and Homes (Shpresat dhe Shtëpitë) në Kosovë, të gjitha kanë ndërmarrë zhvillime të shërbimeve që kanë për qëllim mbështetjen e familjeve të rrezikuara, ngritjen e kapaciteteve, trajtimin e problemeve dhe përmirësimin e cilësisë.

Të gjitha këto elemente, dhe të tjera, do të merren parasysh dhe do të përfshihen në analizën e paraqitur në këtë raport

A.2. Metodologjia e analizës së situatës

Procesi i hulumtimit i ndërmarrë për ta përgatitur këtë raport ka qenë i bazuar në Udhëzimet e Kombeve të Bashkuara për Kujdesin Alternativ të Fëmijëve (i njohur këtu si 'Udhëzimet', i miratuar nga APKB në vitin 2009). Në mënyrë të veçantë është bazuar në parimet kryesore dhe orientimet e politikave të gjetura në Udhëzime.

Udhëzimet janë krijuar për ta siguruar respektimin e dy parimeve themelore të kujdesit alternativ për fëmijët, përkatësisht:

- se kujdesi i tillë është me të vërtetë i nevojshëm ('parimi i domosdoshmërisë'), dhe
- se, kur kjo është kështu, kujdesi ofrohet në mënyrë të përshtatshme ('parimi i përshtatshmërisë').

(Cantwell et al., 2012, p.22)

Gjatë kryerjes së një analize të kujdesit alternativ është e rëndësishme të shikohen pikat hyrëse dhe dalëse apo pikat e tranzicionit, si dhe vendosjet dhe sistemi i punës sociale rreth tyre. Udhëzimet e OKB-së i kushtojnë shumë vëmendje arsyeve pse fëmijët hyjnë në sistem dhe rëndësisë së punës parandaluese. Prandaj, një sistem i fuqishëm i 'sigurimit të portave të sigurta' duhet të jetë funksional për ta shmangur përdorimin e papërshtatshëm dhe të panevojshëm të kujdesit alternativ. Ngjashëm, Udhëzimet i njohin nevojat dhe të drejtat e të rinjve që e lënë sistemin e përkujdesjes për arsye të moshës, d.m.th. për shkak se ata i kanë mbushur 18 vjet. Udhëzimet e bëjnë të qartë se këta fëmijë shpesh janë të ndjeshëm ndaj tranzicioneve të dobëta në moshë të rritur, dhe shumicës prej tyre u mungon mbështetja. Kështu, disa shtete janë duke e zgatur moshën në të cilën fëmijët që kanë qenë nën përkujdesje të mund të marrin shërbime mbështetëse, për shembull deri në moshën 21 apo 25 vjeçare në arsimimin e plotë. (Quinn et al., 2014).

Burimet

Ky raport është bazuar në një numër burimesh; shqyrtimi i raporteve dhe dokumenteve të rëndësishme në zyrë, një periudhë e punës në terren që i ka përfshirë vizitat e familjeve strehuese dhe shtëpive të grupeve të vogla të ofruara nga SOS Fshati i Fëmijëve dhe Caritas; intervistat me akterët kyçë dhe fokus grupet me familjet strehuese. Lista e plotë e dokumenteve të konsultuara, emrat e pjesëmarrësve në fokus grupe dhe njerëzve të intervistuar janë dhënë në Shtojcën 1 dhe 2.

Draft i parë i këtij raporti është dorëzuar fillimisht tek akterët kryesor për komentet e tyre. Ky raport përfundimtar i përfshin korrigjimet dhe komentet e dhëna gjatë punëtorisë "Punëtorja për Miratim" (më 18 nëntor 2015) dhe më pas përmes emailëve.

B. Konteksti i kujdesit alternativ

B. 1. Historiku: Kosova

Që nga korriku i vitit 2015, popullsia e Kosovës është regjistruar me 1,870,981 banorë. Përafërsisht 25% e popullsisë janë të moshës 0-14 vjeç dhe 18% të moshës 15 – 24 vjeç. Në vitin 2013, popullsia e Kosovës janë raportuar të jenë më të varfërit në Evropë me një BPV për kokë banori prej €5,327 dhe një normë papunësie prej 35.5%.² Në vitin 2011, UNICEF-i theksoi se 46.2% e popullsisë jetonin në varfëri absolute (nën €1.42 në ditë) dhe 17.5% në varfëri të skajshme (me €0.93 në ditë)³. Pagesat për familjet nën skemën e asistencës sociale përfshinin ato pagesa që ishin për familjet ku asnjë anëtar i familjes nuk është i aftë për punë, dhe/ose ku i vetmi person i rritur i aftë për punë kujdeset për një person të paaftë mbi moshën 65 vjeç, ose, persona të rritur me një fëmijë nën moshën 5 vjeç apo që i ofrojnë përkujdesje të plotë një fëmijë jetim. Agjencia e Statistikave të Kosovës i paraqet skemat e asistencës sociale si ato që ofrojnë asistencë të përkohshme financiare për familjet të cilat janë vlerësuar kundrejt një kriteri të veçantë si të varfëra. Shuma e asistencës sociale për familjet që jetojnë në varfëri është e pagueshme sipas numrit të anëtarëve të familjes. Në vitin 2015, pagesat sillen prej një familje me dy anëtarë me €55, një familje me gjashtë anëtarë me €75 deri tek familjet me pesëmbëdhjetë anëtarë me €1304. Në vitin 2014, një raport i publikuar nga Komisioni Evropian kërkonte buxhete të shtuara komunale që do të shpenzohen për shërbimet e mbrojtjes së fëmijëve dhe skema të shtuara sociale të dedikuara për fëmijët në strehim familjar dhe fëmijët me aftësi të përhershme të kufizuara.⁵ Në vitin 2008, gjithsej 37,000 ekonomi familjare, ose rreth 162,000 individë, kanë pranuar asistencë, me një përfitim mesatar për ekonomi familjare që në atë kohë ishte €52. Një shtesë për aftësi të kufizuar u paguhet të rriturve në raste të aftësisë së plotë dhe të përhershme të kufizuar dhe mungesës së kapacitetit për të punuar me një shumë totale prej €50 në muaj. Në vitin 2008 ishin 17,675 përfitues.

Një raport i kohëve të fundit i publikuar nga Komisioni Evropian vuri në dukje se raundi i parë i licencimit të kujdestarëve individual social dhe të shërbimeve familjare ka përfunduar dhe ka filluar faza e dytë e licencimit të personave juridik/organizatave. Megjithatë, është raportuar që decentralizimi i shërbimeve sociale ende nuk është zbatuar nga komunat dhe ka nevojë për një alokim të fondeve nga buxheti qendror për të siguruar një proces efektiv⁶.

Në vitin 2014, në një përpjekje për ta vlerësuar përputhshmërinë e kuadrit ligjor të Kosovës me KKBDF, UNICEF-i ka shqyrtuar gjithsej 45 ligje kombëtare⁷. Ata arritën në përfundimin se legjislati ishte në harmoni me standardet ndërkombëtare, duke përfshirë ato ligje që alokonin mbështetje për familjet për të parandaluar abuzimin dhe neglizhencën e fëmijëve, si dhe ato ligje që mandatojnë aspektet e strehimit (kujdesit) familjar. Kushtetuta e Kosovës njeh për shembull, se 'Çdo fëmijë e gëzon të drejtën për raporte të rregullta personale dhe kontakte të drejtpërdrejta me prindërit, vetëm nëse një institucioni kompetent përcakton se kjo

1 Libri Botëror i Fakteve i CIA-s 2015 <https://www.cia.gov/library/publications/the-world-factbook/geos/kv.html>

2 Komisioni Evropian (2015) Dokumenti i Punës i Stafit të Komisionit në Kosovë 2015 Raporti dhe Dokumenti Përcjellës, Strategjia për Zgjerim e KB. Bruksel: Komisioni Evropian

3 UNICEF (2011) Duarte e Bashkuara, Fëmijëria Më e Mirë, Prishtinë: UNICEF Kosova.

4 Zyra e Kryeministrit (2015) Seria e 5 Statistikave Sociale. Prishtinë: Agjencia e Statistikave të Kosovës

5 Komisioni Evropian (2014) Raporti i Progresit për Kosovën. Bruksel: Komisioni Evropian

6 Komisioni Evropian (2015) Dokumenti i Punës i Stafit të Komisionit në Kosovë 2015 Raporti dhe Dokumenti Përcjellës, Strategjia për Zgjerim e KB. Bruksel: Komisioni Evropian

7 UNICEF (2014) Korniza Ligjore për të Drejtat e Fëmijëve në Kosovë, Prishtinë; UNICEF Kosovë

është në kundërshtim me interesin më të mirë të fëmijës⁸. Çështjet në lidhje me unitetin e familjes janë kryesisht të rregulluara me Ligjin për Familjen dhe Ligjin për Shërbimet Sociale dhe Familjare. Edhe Kodi i Familjes parasheh që prindërit do të privohen nga kujdestaria nëse ata abuzojnë ose rëndë neglizhojnë detyrimet e tyre prindërore.

Ligji i Kosovës për Familjen (2004) identifikon se “Fëmijët kanë të drejtë të rriten në një familje me prindër”⁹. Ky Ligj gjithashtu përmban dispozita për mbrojtjen sociale dhe institucionale të fëmijëve pa kujdes prindëror dhe parasheh që asnjë fëmijë nuk mund të hiqet nga përkujdesja e prindit ose kujdestarit ligjor të tij apo të saj pa lejen e tyre apo pa një vendim gjykate. Ai gjithashtu shprehimisht ndalon që fëmijët të vendosen në kujdes alternativ për shkaqe financiare, duke theksuar se “Së pari familja duhet të mbështetet me të gjitha mjetet e mirëqenies sociale¹⁰.” Fëmijët pa përkujdesje prindërore dhe ata të diagnostikuar me vështirësi në mësimnxënie apo probleme shëndetësore, si dhe ata që jetojnë me prindërit që nuk janë të aftë t’i krijojnë kushtet e nevojshme të jetesës për ta, duhet të marrin mbështetje të veçantë financiare dhe sociale nga shteti. Ligji për Familjen mandaton përgjegjësinë e Qendrave për Punë Sociale (QPS) për t’i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për mbrojtjen e fëmijëve dhe atyre pa përkujdesje prindërore duhet t’iu jepet mbrojtje e veçantë përmes kujdestarisë, kujdesit të llojit familjar, në strehimore rezidenciale dhe përmes birësimit.

Vendosja e fëmijëve me lejen e prindërve është gjithashtu e rregulluar me Ligjin për Shërbime Sociale dhe Familjare (2005) dhe amendamentet pasuese (2012). Ky ligj përcakton parimet, mekanizmat dhe procedurat kryesore për ofrimin e shërbimeve mbështetëse dhe kujdesit alternativ për fëmijët. Ai gjithashtu thekson nevojën që fëmijët të konsultohen për të gjitha çështjet dhe që pikëpamjet e tyre të merren parasysh. Ligji vendos përgjegjësinë tek Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) për organizimin e përgjithshëm, koordinimin dhe ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare dhe zhvillimin e politikave dhe planeve strategjike. Institucionet tjera të ngarkuara në kuadër të këtij Ligji për të ofruar shërbime për fëmijë dhe familje, mbrojtjen e fëmijëve dhe kujdesin alternativ, përfshijnë Departamentin e Politikave Sociale dhe i Familjës, Këshillin e Përgjithshëm për Shërbime Sociale dhe Familjare dhe OJQ-të.

Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare (2005) dhe amendamentet pasuese (2012) i mandatojnë QPS-të, që veprojnë si institucione të bazuara në komunë, për të ofruar shërbime sociale dhe familjare dhe asistencë sociale. Nga QPS-të kërkohet të ndërmarrin vlerësime profesionale të nevojave të fëmijëve. Pas një vlerësimi gjithëpërfshirës profesional të nevojave të fëmijëve QPS-të duhet që brenda njëzet e katër (24) orëve t’ia dërgojnë një njoftim drejtorisë përkatëse të komunës.

Nëse ka arsye që të kërkohen masa mbrojtëse, atëherë është e obligueshme që çështja t’i referohet gjykatës. Drejtori i QPS-së duhet t’ia konfirmojë gjykatës që fëmija ka nevojë për mbrojtje nga gjykata dhe që janë marrë parasysh të gjitha alternativat tjera të arsyeshme. Gjykata duhet t’i marrë parasysh një numër faktorësh, duke përfshirë: dëshirat dhe ndjenjat e verifikuara të fëmijëve, nevojat e tyre fizike, emocionale dhe arsimore, efektin e mundshëm tek fëmija nëse vendoset në përkujdesje, ndonjë dëm të pësuar tashmë ose që ka të ngjarë ta pësojë, dhe se sa të aftë janë secili nga prindërit e fëmijës për përmbushjen e nevojave të fëmijës. Nëse gjykata e vlerëson që fëmija ka nevojë për kujdes dhe mbrojtje, ajo është e autorizuar ta nxjerrë një vendim për formën e mbrojtjes në lidhje me fëmijën. Opsionet për një formë të mbrojtjes të tillë përfshijnë:

8 Neni.50.5

9 Nenet.125 (1) dhe 126 (1)

10 Neni.203(4)

- mbikëqyrjen e fëmijës dhe kushteve të tij të jetesës nga zyrtari i shërbimeve sociale, përderisa është nën përkujdesje të prindit/ve ose kujdestarit;
- të drejtat e kujdestarisë të ndara në mes të prindit/prindërve ose kujdestarit/ëve dhe QPS-ës;
- të drejtat e kujdestarisë të bartura tek QPS-ja, ku fëmija vazhdon të qëndrojë në shtëpi;
- të drejtat e kujdestarisë të bartura tek QPS-ja, me kërkesën që përkujdesja për fëmijën të ofrohet larg nga prindi/prindërit ose kujdestari/ët e tij;
- rastet kur fëmija nuk do të jetojë me prindërit e tij/saj duhet të bëhen aranzhime për fëmijën që të ketë qasje ndaj prindit/prindërve ose kujdestarit/ëve të tij/saj;
- periudhën kohore gjatë së cilës forma e mbrojtjes do të jetë në fuqi para se të skadojë ose të shqyrtohet nga gjykata.

Organi i Kujdestarisë siguron përmbushjen e kërkesave dhe kushteve të vendimit për formën e mbrojtjes. Në rastet kur fëmijëve u lëshohet një vendim në formë të mbrojtjes, QPS-ja duhet rregullisht ta shqyrtojë shkallën në të cilën mbrojtja nuk është më e nevojshme apo e përshtatshme. Për tërheqjen e një mbrojtjeje të tillë, Kujdestari duhet ta paraqesë një kërkesë përpara Gjykatës. Ligji e thekson që prindërve apo kujdestarëve fëmija i të cilëve është subjekt i Urdhërit të Kujdestarisë duhet t'u ndihmohet nga QPS-të sa herë që kjo është e mundur, për të sjellë ndryshime në rrethanat e tyre gjë që u mundëson atyre t'i rimarrin të drejtat dhe përgjegjësitë prindërore.. Me qëllim që ta ndihmojë QPS-në, Paneli për Vendorsjen e Fëmijëve është përgjegjës për miratimin e prindërve strehuës dhe prindërve birësues, caktimin e fëmijëve tek prindërit strehuës apo birësues dhe përshtatjen e fëmijëve me prindërit birësues. Pasi të vendoset në strehim familjar, fëmija duhet të vizitohet nga një pjesëtar i ekipit të QPS-së së paku një herë në muaj. Ligji po ashtu i parashikon pagesat që duhet t'u paguhen kujdestarëve duke i përfshirë edhe shpenzimet e tarifave mjekësore.

Diagrami 11 i mëposhtëm ilustron disa prej akterëve kryesorë përgjegjës për ofrimin e shërbimeve sociale në Kosovë.



11 Ndër-marrëdhëniet midis akterëve të ndryshëm (Burimi: Mbështetje për transferimin e shërbimeve sociale në Kosovë, Birks Sinclair & Associates Ltd)

Strategjitë për Strehimin Familjar

Strategjia për Zhvillimin e Mirëqenies Sociale (2012-2016) vë në fokus strehimin familjar, promovon bashkëpunimin ndër-sektorial, duke njohur ndërkohë rëndësinë e mbledhjes së të dhënave dhe përdorimin e procedurave të përbashkëta operative. Ajo përcakton standardet dhe procedurat për strehimin familjar dhe i bën thirrje atyre komunave që nuk kanë shërbimet e strehimit familjar, që t'i zhvillojnë ato. Në Kosovë ekzistojnë rregullore për dy lloje të strehimit familjar. I pari është kujdesi në afat të shkurtër, i cili nënkupton strehimin e përkohshëm për një periudhë të caktuar derisa të gjendet formë tjetër alternative për mbrojtjen afatgjate të fëmijës. Strehim afatgjatë – nënkupton strehimin e fëmijës pa përkujdesje prinderore derisa është e nevojshme kjo formë e mbrojtjes¹².

B. 2. Partneriteti i i Institucioneve të Kosovës dhe OJQ-ve në strehimin familjar

Ka pasur një numër zhvillimesh pozitive për fuqizimin e kapaciteteve të Institucioneve të Kosovës dhe agjencive të saj për të marrë rolin udhëheqës dhe mbikëqyrës; zhvillimi i një regjistri të organizatave të aprovuara është njëri prej tyre, decentralizimi dhe krijimi i Standardeve Minimale dhe një Shërbimi të Inspektimit janë të tjerat. Siç edhe do të tregojë ky vlerësim, boshllëku i implementimit ndërmjet politikës dhe praktikës së QPS-së është i madh dhe tani është i nevojshëm ndryshimi i nivelit të mbështetjes shtetërore për shërbimet sociale të fëmijëve dhe familjes. Fëmijët nën përkujdesje janë fëmijët e Kosovës dhe Qeveria do të duhet t'i rrisë kapacitetet e saj teknike dhe financiare dhe ta zvogëlojë varësinë nga shërbimet e OJQ-ve të financuara nga jashtë. Ata do të vazhdojnë të jenë partnerë të rëndësishëm me Ministrinë dhe komunën dhe do të ndihmojnë në zhvillimin e shërbimeve sociale të Kosovës, por gjatë disa viteve të ardhshme Qeveria do të vazhdojë ta marrë udhëheqjen e shërbimeve sociale.

OJQ-të janë duke luajtur një rol shumë të rëndësishëm në kujdesin alternativ në Kosovë. OJQ-të përfshijnë OJQ-të lokale të tilla si Shpresa dhe Shtëpitë e Kosovës (Hope and Homes Kosovo), dhe koalicioni i OJQ-ve KOMF. OJQ-të ndërkombëtare luajnë një rol shumë të madh në ofrimin e shërbimeve, ku SOS Fshati i Fëmijëve, Amici dei Bambini dhe Caritas nga Italia, janë veçanërisht të spikatur. Të gjitha këto organizata janë të financuara nga jashtë dhe shërbimi i tyre në Kosovë është tipik për misionet e tyre përkatëse; i cili mund të përmbledhet si prezantim i shërbimeve të cilësisë së mirë kudo që ato janë më të nevojshme në të gjithë botën, dhe ofrimi i ndihmës për të ndërtuar kapacitetet e partnerëve lokalë në qeveri dhe shoqëri civile.

Natyrisht Institucionet dhe populli i Kosovës kanë mirëpritur këto shprehje të mëshirshme dhe profesionale të solidaritetit. Siç është vërejtur në 1. më lart, Kosova ka një sistem të Qendrave për Punë Sociale, të cilat veprojnë nën udhëzimet dhe legjislacionin e bazuar në të drejtat dhe udhëzimet bashkëkohore. Megjithatë, numri i punonjësve social është shumë i vogël, ata mbulojnë një numër të madh të popullsisë dhe secili punonjës social ka përgjegjësi për një gamë të plotë të detyrave të punës sociale; duke përfshirë mbështetjen për të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara, si dhe fëmijët dhe familjet në nevojë. Ekziston një mungesë e specializimit - për shembull në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve ose strehimin familjar - dhe është fakt gjerësisht i pranuar se Qendrave u mungojnë kapacitetet dhe resurset adekuate profesionale dhe financiare (UNICEF, 2014; Kolegjiumi i AKK, 2013; KOMF 2014 a dhe b). Zhvillimet në kujdesin dhe mbrojtjen e fëmijëve në 15 vitet e fundit janë mbështetur në një masë të konsiderueshme tek OJQ-të ndërkombëtare, duke punuar në partneritet me Ministrinë dhe QPS-të për të ngri-

12 Udhëzimi administrativ nr.13/2012 për rregullimin e strehimit familjar në Kosovë

tur aftësitë dhe kapacitetet e tyre.

Edhe pse strehimi familjar është inicuar dhe mbajtur në masë të madhe nga OJQ-të ndërkombëtare, është një shërbim i rëndësishëm (jo vetëm për shkak se ai siguron opsione të përkujdesjes familjare për fëmijë), por për shkak se kostot e drejtpërdrejta të vendosjes mbulohej nga qeveria, e jo nga OJQ-të Ndërkombëtare. QPS-të janë të përfshira në vlerësimin e familjeve strehuese, dhe Paneli për Vendosjen e Fëmijëve aprovon strehuesit dhe i përshtat fëmijët me vendin ku do të vendosen. Është gjithashtu një shërbim në të cilin disa nga QPS-të angazhohen në aspektin e vendosjes së fëmijëve, madje edhe ato QPS që nuk i kanë rekrutuar familjet e tyre strehuese. Kjo është një arsye pse në aspektin strategjik është e rëndësishme të fuqizohet ky shërbim. Strehimi familjar nuk është një shërbim i lirë; ai kërkon investime të konsiderueshme në sistemin përcjellës të punës sociale (Koalicioni 'Familja për Çdo Fëmijë', 2014). Megjithatë, ky duhet të jetë një prioritet për qeverinë pasi ai do të krijojë një grup të opsioneve të vendosjes së bazuar në familje, të financuar dhe zhvilluar lokalisht. Për momentin, kategoria e fëmijëve të vendosur në strehim familjar është shumë e kufizuar, duke qenë kryesisht të porsalindur dhe foshnja me disa fëmijë pak më të rritur, zakonisht nga grupet vëllamotër. Nëse bëhet më i larmishëm se baza e tanishme, atëherë një kategori shumë më të gjerë të fëmijëve mund t'u sigurohet kujdesi lokal i bazuar në familje. Ekziston një mbështetje e fortë nga ekspertë të ndryshëm profesional, përfshirë edhe AiBi, për idenë e rekrutimit të 'kategorive' të ndryshme të strehuësve, të cilët do të miratohen për të ofruar shtëpi për fëmijët e moshave dhe nevojave të ndryshme. Drejtori i QPS në Prishtinë tha,

Familjet e rekrutuara strehuese duhet të jenë të gatshme dhe të trajnuara për t'u kujdesur për kategoritë e ndryshme të fëmijëve. Veçanërisht ka nevojë shumë të madhe për strehuës familjar të cilët janë në gjendje të kujdesen për fëmijët e abuzuar (keqtrajtuar).

Për të arritur këtë, janë të nevojshme angazhime të reja të mëdha, veçanërisht në lidhje me financimin e shërbimeve për punë sociale dhe vendosjen nën përkujdesje. Me rritjen e pasurisë së përgjithshme të Kosovës, dhe buxhetit, edhe buxheti i DPS&F mund të rritet në mënyrë të qëndrueshme ashtu që Ministria të fillojë të mbulojë një pjesë të konsiderueshme të shpenzimeve për vendosjet rezidenciale dhe mbështetjen e strehimit familjar. Marrja e përgjegjësisë do të thotë të fitosh kontroll më të madh. Hapat në këtë drejtim do të përputhen me rritjen e kapaciteteve dhe profesionalizmit të punëtorëve social të QPS-ve siç janë parashikuar me Standardet Minimale.

Ofrimi i shërbimeve sociale asnjëherë nuk është 'fitues i votës' në ndonjë vend. Megjithatë, të gjitha qeveritë që aspirojnë të përmbushin nevojat e qytetarëve të saj më të rrezikuara e dinë se vendimet e guximshme duhet të merren për të siguruar shërbime sociale profesionale. Shërbimet sociale profesionale që punojnë në kuadër të kornizës së standardeve dhe të drejtave kombëtare atëherë do të mund të ofrojnë mbështetje të cilësisë së mirë për familjet e rrezikuara dhe fëmijët e tyre.

B. 3. Ndikimi i De-centralizimit në Qendrat për Punë Sociale

Decentralizimi i shërbimeve dhe detyrave tek komunat është bërë në vitin 2009. Megjithatë, në lidhje me QPS-të ende nuk është i plotë dhe mbetet një temë e diskutueshme. Duket se ka pak dyshim se mënyra se si është realizuar ka pasur një ndikim negativ në zhvillimin e shërbimeve të punës sociale, duke përfshirë edhe strehimin familjar. Menaxherët e punës sociale e përsërisin raportin e Komisionit Evropian që është cituar më herët në këtë raport (f.9). Ata këmbëngulin se procesi

i decentralizimit ende nuk është i plotë; me të cilën ata kryesisht duan të thonë që buxhetet nuk janë decentralizuar. Megjithatë, sipas Ministrisë, procesi i decentralizimit është zgjidhur, dhe se si Ministria ashtu edhe komunat i kanë të përcaktuara qartë rolet dhe përgjegjësitë. Raporti i fundit i AiBi përmbledh situatën në këtë mënyrë:

Në fushën e shërbimeve sociale, transferimi i prituri i kompetencave në nivel lokal i zhvilluar në dy vitet e fundit pësoi të njëjtat të meta të procesit kryesor: nëse pronësia në programimin dhe ofrimin e shërbimeve është vendosur në duart e komunës, struktura organizative dhe administrative është ende e lidhur në masë të madhe me autoritetet qendrore; resurset ekonomike në dispozicion në nivel lokal janë të pamjaftueshme për shkak të transferimit financiar jo të plotë nga ana e Shtetit, i cili merr pjesën më të madhe të të ardhurave nga taksat.

(AiBi, 2014, p.5)

Buxhetet e QPS-ve

Si pjesë e procesit të decentralizimit QPS-të janë vendosur brenda një Drejtorati të kombinuar të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale (DShMS) në nivel komunal. Pagat dhe kostot e zyrës së stafit të QPS janë të përfshira në financimin e DShMS, por përveç kësaj nuk ka buxhet në dispozicion për Drejtorin e QPS-së për të mbuluar aktivitetet e përditshme të punës sociale. Është DShMS-ja ajo që e mban tërë buxhetin operacional, dhe Drejtorët e punës sociale duhet të aplikojnë për financim për çdo pjesë të vetme të shpenzimeve - për shembull për të mbuluar kostot e shëndetit të një fëmije individual në strehim familjar.

Pothuajse në çdo rast DShMS udhëhiqet nga një profesionist shëndetësor, dhe ata shpesh kanë pak njohuri apo përvojë të drejtpërdrejtë për shërbime sociale. Kërkesat në këtë drejtorate të kombinuar janë shumë të mëdha. Nën këto rrethana, është politikisht e vështirë (siç do të ishte në çdo vend) të ndahet një buxhet për punë sociale, i cili i shërben vetëm një përqindjeje të vogël dhe shpesh të stigmatizuar të popullatës, kur ka aq shumë kërkesa për shërbime shëndetësore, të cilat i shërbejnë një pjese shumë më të madhe të popullsisë.

Nuk ka asnjë dyshim se fakti që Drejtorët e punës sociale nuk kanë buxhet nën komandën e tyre të drejtpërdrejtë është një problem i madh. Kjo dëmton profesionalizmin, moralin dhe llogaridhënien. Kjo mund t'i bëjë disa QPS të hezitojnë të marrin përsipër përgjegjësi të tilla si rekrutimin e më shumë familjeve strehuese, me të gjitha shpenzimet e përfshira në përkrahjen dhe mbikëqyrjen e tyre, si dhe ndërmarrjen e vizitave të fëmijëve që janë në strehim familjar. Drejtorët e QPS-ve janë ballafaquar me të paturit nevojë ta edukojnë eprorin e tyre në DShMS për punën dhe detyrat e tyre. Kjo nuk duhet të jetë e nevojshme duke pasur parasysh që QPS-të kanë një histori të gjatë brenda Kosovës dhe puna e tyre udhëhiqet nga legjislacioni dhe udhëzimet e kohëve të fundit dhe që janë në zgjerim e sipër.

Kjo çështje është e njohur që prej kohësh dhe QPS-të vazhdimisht e ngrisin atë. Sektori i OJQ-ve ka njohur rëndësinë e kësaj çështjeje dhe Koalicioni i organizatave për mbrojtjen e fëmijëve ka botuar një raport shumë të dobishëm, duke identifikuar nivelet aktuale të shpenzimeve në nivel komunal (A janë duke arritur paratë e tatimpaguesve tek fëmijët në nevojë? UNICEF dhe KOMF, prill 2014). Ata gjithashtu kanë paraqitur opsionet e punuara me kujdes për mundësitë e krijimit të buxheteve për QPS-të, duke filluar në një nivel shumë modest.

Po ashtu ka pasur punë në ngritjen e kapaciteteve në këtë fushë, të realizuara nën kujdesin e DfID MB Programit për Decentralizimin e Shërbimeve Sociale në Kosovë (Buletini Final, 2012). Ky program ka shqyrtuar dhe fuqizuar fushën e menaxhimit financiar, buxhetimit dhe planifikimit, të cilat janë padyshim të rëndësishme për zhvillimin e një shërbimi të decentralizuar. Prandaj është urgjente që QPS-të tani të kenë mundësinë për të vënë në veprim ekspertizën e tyre të fituar në kohët e fundit. Nuk ka asnjë dyshim se përparimi në këtë fushë është i rëndësishëm vendimtarë për zhvillimin e një shërbimi të strehimit familjar, që është themeluar në mënyrë më të sigurtë dhe që është me të vërtetë kosovare.

Institucionet e Kosovës kanë ka theksuar se ka për ta futur një klauzolë në ligjin e ardhshëm për Mbrojtjen e Fëmijëve për të siguruar financim të përkushtuar për shërbimet sociale komunale. Propozimi që është duke u shqyrtuar është se përqindja fikse e grantit kryesor vjetor për Komuna do të ndahet për QPS-të. Projektligji për Mbrojtjen e Fëmijëve është duke u diskutuar që sa kohë dhe pritet që të miratohet në vitin 2016. Data kur do të fillojë buxheti i përcaktuar për QPS-të ende nuk është shpallur.

Kolegjiumi për Strategjinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

Një zhvillim i kohëve të fundit ka qenë krijimi i një Kolegjiumi për Planin Strategjik për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale që mbulon periudhën 2014-16. Kolegjiumi për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale është një nga 12 të krijuarat nga Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK), i cili është mbështetur nga AiBi. Bashkëpunimi dhe shkëmbimi i përvojës dhe ekspertizës është veçanërisht i rëndësishëm në fusha të reja dhe të nën-zhvilluara të aktiviteteve të QPS, të tilla si strehimi familjar. Strategjia aktuale është një dokument i shkurtër që adreson disa fusha të rëndësishme të punës; strehimin familjar; punën e fëmijëve, drejtësinë për të mitur, mbrojtjen e fëmijëve në lidhje me dhunën, gratë dhe dhunën në familje. Gjithëpërfshirja e strehimit familjar të fëmijëve është vendimtarë dhe sigurisht përbën një angazhim të fortë nga të gjitha Komunitat për ta fuqizuar atë. Strategjia është e sinqertë në lidhje me sfidat me të cilat ballafaqohen anëtarët:

- Fakti që nuk i mbulon të gjitha komunitat dhe se familjet strehuese janë të pakta në numër në këtë moment
- Mungesa e aktiviteteve të koordinimit
- Monitorimi i kufizuar dhe mungesa e resurseve për menaxherë të rasteve
- Pagesa e ulët dhe mungesa e përfitimeve specifike sociale apo shëndetësore që mund ta rrisin statusin e detyrës.

Përfundimi për decentralizimin

Është shumë e rëndësishme që procesi i decentralizimit të përfundohet në një mënyrë që mjaftueshëm i fuqizon komunitat për t'i kryer funksionet e tyre. Ministria dhe komunitat duhet të vijin në një mirëkuptim të përbashkët në lidhje me rolet e tyre përkatëse në lidhje me fëmijët në kujdesin alternativ. Ata duhet të bashkëpunojnë në mes vete në mënyrë aktive dhe të vazhdojnë të zhvillojnë strategji të përbashkëta dhe kapacitetin e QPS-ve.

Është e qartë se në fakt menaxhimi dhe kujdesi për fëmijët në kujdesin alternativ është një përgjegjësi e përbashkët, dhe do të vazhdojë të jetë kështu në të ardh-

men e parashikueshme. Kosova është një vend i vogël, dhe ka sasi të kufizuar të ekspertizës profesionale në këtë fushë. Ministria vazhdon të kryejë funksione të rëndësishme që shkojnë përtej vendosjes së drejtimit të politikave dhe lëshimit të udhëzimeve. Për shembull, Ministria vazhdon ta drejtojë Panelin për Vendosjen e Fëmijëve, i cili luan një rol të rëndësishëm në lidhje me vendosjen e fëmijëve në strehimin familjar, birësimin dhe monitorimin e braktisjes së fëmijëve. Kryerja e pagesave për familjet strehuese/kujdestarët e fëmijëve gjithashtu mbahet në nivel qendror -dhe ka argumente në favor të mbajtjes së këtij aranzhmani, pasi që ai siguron nivele të qëndrueshme të pagesës dhe mundëson që një organ të mbajë një pasqyrë gjithëpërfshirëse. Megjithatë, buxhetet tjera operative; që mbulojnë udhëtimin për vizita monitoruese, takime për planifikim të kujdesit, trajnimet, etj., janë të nevojshme në nivel lokal.

B. 4. Braktisja e foshnjave

Braktisja apo heqja dorë* nga foshnjat është një çështje serioze me të cilën ballafaqohet shoqëria kosovare, dhe për pasojë edhe sistemi i shërbimeve sociale. Një nivel veçanërisht i lartë i braktisjes ishte një nga pasojat e luftës dhe përçarjes sociale afatgjatë të shkaktuar nga lufta. Numri i foshnjave të braktisura është ulur ndjeshëm që nga ajo kohë, nga niveli më i lartë prej 150 deri në nivelin aktual prej rreth 50 foshnja në vit. Ndikimi i drejtpërdrejtë i konfliktit ka rënë, por stigma sociale e lidhur me fëmijët e lindur jashtë martese, mbetet një problem i madh, dhe ai është një problem që ka marrë shumë vëmendje nga Qeveria, OJQ-të dhe organizatat e avokimit. Raporti I i kohëve të fundit nga KOMF (2014a) shqyrtoi reagimet e shërbimeve shëndetësore dhe sociale për foshnjat nga të cilat është hequr dorë në spital, dhe qëndrimet e gjata në spital për disa fëmijë.

*Termi 'heqje dorë' mund të jetë një term më i mirë për përdorim nga profesionistët pasi që ai është më pak gjykues në ton se sa termi " i braktisur", dhe më saktë pasqyron faktin që fëmijët të cilëve ne u referohemi janë lënë nga nënat e tyre (dhe familjet) nën përkujdesjen e të tjerëve, zakonisht të departamenteve të maternitetit në spitale.

Janë ndërmarrë veprime pozitive dhe të vlefshme;

- Ministritë e Shëndetësisë dhe të Punës dhe Mirëqenies Sociale kanë punuar së bashku në një Memorandum Mirëkuptimi i cili u ka dhënë udhëzime departamenteve të maternitetit dhe QPS-ve se fëmijët nuk duhet të mbesin në spital për më shumë se 21 ditë përveç nëse kanë probleme të jashtëzakonshme mjekësore.
- SOS 'Shtëpia e tranzicionit për foshnja' është ri-zhvilluar për të krijuar një strukturë më pak institucionale ('Shtëpia e Foshnjave' për 6-fëmijë), me vëmendje më të qëndrueshme nga një kujdestar kryesor për secilin grup të foshnjave.
- Shërbimi i strehimit familjar është zhvilluar në disa pjesë të vendit dhe strehuesit familjarë janë duke u kujdesur me sukses për një numër të konsiderueshëm të foshnjave nga të cilat kanë hequr dorë.

Megjithatë, mbeten sfida të konsiderueshme në lidhje me kujdesin ndaj foshnjave, duke përfshirë;

- Mungesën e punës parandaluese të ndërmarrë nga Qendra Klinike Universitare e Kosovës (Spitali i Prishtinës) dhe QPS-të
- Përdorimin e vazhdueshëm të kujdesit në grup, megjithëse në grupe të vogla, në 'Shtëpitë e foshnjave'

- Periudhat e panevojshme kohore në spital për disa fëmijë të shëndetshëm
- Strehuesit familjarë janë në dispozicion, por nuk shfrytëzohen
- Vonesat në zgjidhjen e statusit ligjor të fëmijëve

Departamenti i Maternitetit në Spitalin e Prishtinës pranon numrin më të madh të foshnjave prej të cilave kanë hequr dorë, dhe përfiton nga punëtori/ja social/e në grupin e stafit. Megjithatë roli i tij/saj është kryesisht administrative, duke informuar QPS-të për nënat që kanë për synim të heqin dorë nga foshnjat e tyre, dhe aranzhojnë transfere për në SOS 'Shtëpinë e tranzicionit për foshnja' nëse QPS-ja nuk është në gjendje ta caktojë një strehues familjar.

Ekziston një nevojë urgjente që Spitali i Prishtinës, dhe departamentet tjera të maternitetit (në partneritet me QPS-të) të ndër marrin këshillime mbështetëse për t'i inkurajuar nënat që t'i mbajnë fëmijët e tyre.

Një punë e tillë parandaluese ka nevojë për resurse të përshtatshme në kuadër të spitaleve, përfshirë hapësira të rehatshme dhe të besueshme ku nënat, baballarët dhe familjet që janë duke përjetuar periudha stresuese të mund të bisedojnë së bashku dhe me punëtorë social apo me këshilltarë. Ka të ngjarë që puna parandaluese do të jetë e suksesshme vetëm nëse punëtorët social dhe këshilltarët të mund të kenë qasje në shërbimet shtesë të komunitetit, siç është strehimi shtëpiak afatshkurtër (d.m.th akomodimi 'nëna me foshnjën').

B. 5. Numri i fëmijëve aktualisht në kujdesin alternativ

'Organi i Kujdestarisë' për të gjithë fëmijët që nuk janë nën kujdestarinë e prindërve të tyre biologjik i takon QPS-së. Në rastin e kujdesit të fëmijëve nga farefisi, kujdestaria mund të kalojë tek një tjetër anëtar i familjes së gjerë. Janë punonjës socialë ata të cilët veprojnë si 'Kujdestar ligjor' për të gjithë fëmijët që përndryshe nuk kanë një pjesëtar të familjes së tyre të gjerë për të vepruar si kujdestar i tyre. Në fakt kjo do të thotë që fëmijët në strehim familjar dhe përkujdesje rezidenciale kanë edhe një kujdestar ligjor edhe një punonjës social të dytë (menaxheri i rastit). Rregulloret kërkojnë që një punonjës social nuk mund të jetë edhe kujdestar ligjor edhe menaxher i rastit për të njëjtin fëmijë. Vlen të përmendet këtu se kjo detyrë vë një barrë të konsiderueshme shtesë mbi punonjësit socialë.

Ministria jep një shifër të përgjithshme prej 1279 fëmijëve nën kujdestari në vitin 2015.

Megjithatë, kjo shifër përfshin 505 fëmijë në një shumëllojshmëri të rrethanave të veçanta që kanë të bëjnë me konfliktin, dhe të cilët nuk kanë vizita monitoruese nga QPS-të, dhe përfshijnë:

- Fëmijët që përfitojnë nga skema financiare e familjeve të dëshmorëve të luftës dhe viktimave civile të luftës;
- Fëmijët të cilët janë nën kujdesin e të afërmeve dhe të cilët nuk përfitojnë nga skemat sociale dhe format tjera të mbrojtjes;
- Fëmijët të cilët janë nën kujdesin e të afërmeve kur prindërit jetojnë jashtë vendit

Prandaj, duke përjashtuar këta fëmijë nga totali i fëmijëve për të cilët Ministria ka informata, kjo prodhon një shifër prej 774 fëmijëve në kujdesin alternativ formal.

Tabela e mëposhtme mbledh së bashku të gjitha informatat në dispozicion në lidhje me këto vendosje në kujdesin alternativ formal.

Tabela 1: Numri i fëmijëve aktualisht në kujdesin alternativ sipas llojit të vendosjes

Lloji i vendosjes	Informatat mbi vendosjen	Nr i vendosjeve /fëmijë	Nr i fëmijëve
Kujdesi farefisnor*	Familja që merr përfitimin nga kujdesi të të afermit, Monitorohet nga QPS-të	590	590
Kujdesi në familje strehuese	Aprovuar nga Ministria e P&MS, mbështetur nga OJQ Amici dei Bambini	35 familje me 68 fëmijë, (50 familje të aprovuara) **	68
SOS Fshati i Fëmijëve Kosovë	Shtëpia e tranzicionit (24) /për foshnja (3x 6)	24	18
	Shtëpitë e komunitetit (7 x 6)	42	39
	Shtëpia e Të Rinjve	12	11
Shpresa dhe Shtëpitë e Fëmijëve Kosovë – kujdesi rezidencial	Fëmijët nga 3-18 vjeç	18	6
Kujdesi rezidencial i Caritas	Fëmijët nga 3-18 vjeç	14	14
Shtime	kujdesi rezidencial për fëmijët me aftësi të kufizuara	10***	6
Nr total i vendosjeve		778	752

Informacioni i dhënë nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (Shtator 2015)

* Kujdesi farefisnor në këtë tabelë i referohet kujdesit farefisnor ‘formal’. Kujdestarët e farefisnisë marrin një përfitim të vogël në të holla (aktualisht 75 € në muaj për një fëmijë) dhe të gjitha rastet janë regjistruar nga qendra për punë sociale (QPS). Cilësia e kujdesit dhe mbështetja e punës sociale për këto vendosje adresohen nga Standardet Minimale të Kujdesit (nr.14) të qarkulluara së fundmi nga Ministria.

** Aktualisht 35 familje strehuese kanë fëmijë që janë vendosur tek ata, nga një total prej 50 familjeve të aprovuara nga Paneli i Vendosjes së Fëmijëve (I Drejtuar nga Ministria).

*** Qendra rezidenciale në Shtime është shtëpi për fëmijët me aftësi të kufizuara të rënda. Megjithatë, 4 banorë janë mbi moshën 18 vjeç, dhe mbesin në Shtime deri në krijimin e një akomodimi të ri.

C. Strehimi familjar në vitin 2015

C. 1. Shqyrtim i Përgjithshëm

Strehimi familjar së pari ka filluar të zhvillohet në Kosovë në vitin 2001, dhe puna e zhvillimit, rekrutimit dhe mbështetjes për strehuesit familjarë është ndërmarrë nga OJQ-të më të mëdha dhe me përvojë në këtë fushë: fillimisht nga OJQ-ja ndërkombëtare EveryChild me seli në Mbretërinë e Bashkuar, dhe kur ajo u tërhoq nga Kosova, roli i saj në mbështetje të strehimit familjar është marrë përsipër nga Save the Children, dhe pastaj në vitin 2007 OJQ-ja italiane, Amici dei Bambini, mori përsipër rolin kryesor mbështetës dhe zhvillimor. Strehimi familjar është përcaktuar në mënyrë të qartë në legjislacion dhe në udhëzime, dhe Standardet Minimale specifike dhe të detajuara janë zhvilluar dhe qarkulluar kohët e fundit.

Në vitin 2002, me përkrahjen financiare dhe teknike të UNICEF-it dhe EveryChild, Ministria ka hartuar dhe miratuar 'Manualin e Procedurave për vendosjen e fëmijëve në kujdesin alternativ' të detajzuar, i cili i dha udhëzime QPS-ve për rolin e tyre në miratimin dhe monitorimin e strehuesve familjarë, dhe këto udhëzime po ashtu adresuan procesin e menaxhimit të rasteve, shqyrtimin dhe planifikimin e kujdesit, caktimin e roleve dhe detyrave për menaxherët e rasteve dhe përfaqësuesit ligjorë në kuadër të QPS-ve.

Përgjegjësinë për rekrutimin, vlerësimin dhe përgatitjen e prindërve strehues e ka QPS-ja. Pasi prindërit strehues të jenë vlerësuar për të parë nëse i plotësojnë kriteret bazë, QPS-ja ia dërgon raportin Panelit për Vendosjen e Fëmijëve, i cili është i organizuar nga dhe gjendet në kuadër të Departamentit për Politika Sociale dhe për Familje, në MPMS. OJQ-ja ndërkombëtare, AiBi, gjithashtu luan një rol të rëndësishëm në mbështetjen e familjeve strehuese individuale, si dhe në mbështetjen e QPS-ve dhe funksionimin e sistemit.

Në periudhën 2012-14 AiBi ndërmori një projekt të madh, i cili siguroi zhvillimin e një sërë mjetesh për QPS-të dhe trajnime të rëndësishme (5 ditë) për atë se si të përdoren ato. Ata gjithashtu siguruan një numër të pozitivave të psikologut me orar të plotë që të jenë në dispozicion të familjeve strehuese për t'i këshilluar dhe mbështetur. Gjithashtu janë ofruar trajnime dhe programe sociale për familjet strehuese, të cilat janë burime shumë të dobishme për familjet strehuese.

Pagesat për strehuesit familjarë

Strehuesit familjarë marrin pagesa mujore të njëjta, të cilat kanë për qëllim t'i kompensojnë ata për shpenzimet e rritjes së një fëmije. Norma aktuale është 150€, dhe 250€ për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Ekziston një mendim mjaft i përhapur, jo më pak i shprehur edhe nga strehuesit familjarë, si dhe nga Drejtorët e QPS-ve dhe Strategjia e Kolegjiumit, se ky nivel i pagesës është tepër i ulët. Një numër i vogël i komunave kanë siguruar buxhetin për të paguar me nga 100/150€ shtesë në muaj për strehuesit familjarë të tyre, dhe komunat tjera, duke përfshirë Prishtinën, janë duke shqyrtuar kërkesa të ngjashme nga Drejtorët e tyre. Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se kjo shifër është shumë më e lartë sesa pagesa e mbrojtjes sociale që u paguhet familjeve të varfra, në rastet kur askush nuk është në gjendje ose në dispozicion për të punuar, (aktualisht familjet me 2 persona marrin 60€ me një shtesë prej 5€ për person).

Drejtorët e intervistuar për këtë vlerësim, si dhe ekspertët tjerë, mendojnë se është e nevojshme një rritje e konsiderueshme e pagesës për të tërhequr një grup më të gjerë të njerëzve që mund të vënë veten në dispozicion si strehues të mundshëm familjarë në të ardhmen.

Shpenzimet shëndetësore

Shpenzimet shëndetësore janë një barrë tjetër e madhe për strehuesit familjarë, të cilët kompensohen vetëm herë pas here, dhe atë me vështirësi. Natyrisht, strehuesit familjarë shpesh duhet t'i plotësojnë nevojat mjekësore të fëmijëve për të cilët kujdesen dhe kjo rezulton nganjëherë me shpenzime shtesë për ta bërë një gjë të tillë. Është raportuar se ekzistojnë protokolle apo procedura që inkurajojnë DShMS-të komunale për ta njohur situatën e veçantë të familjeve strehuese dhe për ta bërë më të thjeshtë kompensimin e shpenzimeve të kujdesit shëndetësor. Kjo duket sikur një çështje e drejtësisë natyrore, pasi që fëmijët janë në fund të fundit nën kujdesin e shtetit. Dështimi i vazhdueshëm për të implementuar sisteme efektive cenon standardet e kujdesit dhe vlerën e vendosur mbi strehuesit familjarë. Dështimi për të zgjidhur çështjen në praktikë paraqet një kontradiktë të qartë ndaj qëndrimeve të politikave të Qeverisë dhe profesionit. Duhet të theksohet se në fakt strehuesit familjarë shpesh i mbulojnë këto shpenzime shëndetësore nga xhepat e tyre, dhe vazhdojnë t'i dërgojnë fëmijët e tyre për trajtim mjekësor, edhe pse ata e dinë se ri-kthimi i shpenzimeve do të jetë problem.

C. 2. Numri i familjeve dhe disponueshmëria

Që nga viti 2009, dhe me ardhjen e decentralizimit, shërbimi i strehimit familjar nuk është zgjeruar në numrat ose në kategoritë e fëmijëve të cilëve u ka shërbyer. Raportet sugjerojnë se ka pasur rreth 40 familje strehuese aktive që nga ajo kohë. Gjatë këtyre viteve ka pasur një shkallë të qarkullimit natyral; disa prindër të familjeve strehuese që e kanë ndërprerë strehimin e fëmijëve për shkak të ndryshimit të rrethanave familjare; disa strehues familjarë janë vlerësuar të jenë të papërshtatshëm dhe nuk janë duke u përdorur më. Janë rekrutuar disa familje strehuese të reja. AiBi raporton se një total prej 5 familjeve të reja janë rekrutuar këtë vit (janar - shtator 2015). Megjithatë, shifrat e fundit tregojnë se përderisa numri i prëgjithshëm i familjeve strehuese mbetet i qëndrueshëm, niveli aktual i shërbimeve është në të vërtetë në rënie, ku ministria raporton se në përgjithësi janë 50 familje aktive dhe të gatshme për të marrë fëmijë, por në fakt vetëm 35 prej tyre kanë fëmijë të vendosur tek ata. Kjo tregon se shumë QPS nuk janë duke e marrë parasysht përdorimin e strehuesve familjarë dhe se ka probleme me Panelin e Vendosjeve i cili vazhdon të bëjë vendosje në shtëpinë 'tranzicionale' të drejtuar nga SOS Fshatrat e Fëmijëve në vend që të bëjë vendosjen tek strehuesit familjarë që janë aktualisht në dispozicion. Kjo çështje është shqyrtuar edhe më tej në vijim, shih f.23.

C. 3. Rekrutimi

Ka shumë pak dëshmi për rekrutimin e familjeve strehuese nga ana e QPS-ve. Edhe pse kohë pas kohe ka pasur fushata publicitare dhe mbulim mediatik të disa familjeve strehuese, Drejtorët e QPS-ve dhe AiBi konfirmojnë se forma më e zakonshme e rekrutimit është rezultat i 'fjalës-së-gojës' nga familjet strehuese ekzistuese, të cilët më pas inkurajohen dhe përgatiten nga AiBi. Përderisa është gjithmonë e vlefshme që ta kemi këtë kanal të rekrutimit, kjo është një qasje shumë e kufizuar e rekrutimit. Një problem i madh është se me këtë do të kemi prirje për ta kufizuar profilin social-ekonomik të familjeve strehuese dhe të mos kemi përfaqësues të popullatës si tërësi.

Në janar të këtij viti, Ministria nxorri një memo për të gjitha QPS-të, duke i udhëzuar ato që t'i rekrutojnë 3 familje strehuese të reja deri në tetor, por kjo nuk është arritur nga asnjë komunë. Siç u përmend më lart, një total prej 5 familjeve të reja janë rekrutuar në mbarë Kosovën. Kjo është një dëshmi e zymtë se strategjitë aktuale nuk janë efektive në sigurimin dhe zhvillimin e shërbimit të tyre të strehimit familjar, dhe sugjeron se një ndryshim i qasjes ndaj rekrutimit dhe mbikëqyrjes së familjeve strehuese është i nevojshëm.

Siç shihet më sipër, mungesa e ndonjë buxheti të kaluar tek QPS-të pas decentralizimit pa dyshim ka cenuar zhvillimin e punës sociale në përgjithësi, dhe zhvillimit të strehimit familjar konkretisht. Në këtë kontekst, ndoshta është e kuptueshme, edhe pse për të të ardhur keq, që punonjësit socialë dhe menaxherët e tyre në disa QPS mund të vendosin se punën e gjetjes, rekrutimit, mbështetjes dhe mbikëqyrjes së familjeve të reja, duke pasur parasysh shpenzimet e përfshira - duhet pezulluar apo shmangur. Një Drejtor i intervistuar gjatë këtij vlerësimi shpjegoi se ai ishte përpjekur të rekrutojë, por se ishte vërtetuar se thjeshtë ishte e pamundur për të gjetur familje që janë të gatshme të përfshihen. Si rezultat i kësaj, duket sikur ai kishte hequr dorë dhe nuk kishte asnjë ide se si të lëvizte përpara. Një tjetër Drejtor tha se ai kishte disa familje që kishin shprehur interesim, por ai mendon se niveli i ulët i pagesës ishte pengesa kryesore. Ai kishte aplikuar në komunën e tij për një pagesë shtesë dhe kishte shpresë se nëse kjo i aprovohej, atëherë ai do ta gjente një numër të familjeve të gatshme për të strehuar fëmijë. Megjithatë, duhet të theksohet se disa komuna i kanë tejkaluar këto pengesa - ata i kanë rekrutuar disa familje.

C. 4. Menaxhimi i rasteve dhe partneriteti ndërmjet punonjësve social dhe strehuesve familjarë

Për fat të keq ka dëshmi të bollshme se punonjësit socialë të punësuar nga QPS-të nuk janë duke i kryer detyrat e tyre ashtu si i udhëzon manuali i procedurave (2002), dhe se zbatimi i Standardeve Minimale, të miratuara kohët e fundit, ka të ngjarë të dëshmohet si sfidues. Familjet strehuese dhe AiBi raportojnë se vizitat monitoruese shpesh shtyhen dhe në disa raste nuk ndodhin me muaj të tërë. Sipas strategjisë së Kolegjiumit të AKK-së,

'aktivitetet monitoruese ndaj fëmijëve në strehim familjar dhe familjeve strehuese nuk janë të efektshme për shkak të mungesës së sistemit të mirë-definuar të monitorimit dhe resurseve në dispozicion për menaxherin e rastit'
(Strategjia e Kolegjiumit të AKK-së për Shëndetin dhe Mirëqenien Sociale 2013, f.9)

Standardet Minimale të zhvilluara së fundmi për strehimin familjar mund ta adresojnë aspektin e parë, por resurset mbesin një sfidë e madhe. Familjet strehuese në dy prej komunave të konsultuara për këtë raport, kanë mendime përgjithësisht pozitive për punëtorët e tyre socialë, edhe pse ata e kanë përmendur që vizitat e rregullta ndonjëherë janë shtyer. Në të vërtetë, ata duket se kishin mirëkuptim mjaft të madh për ata në aspektin e mungesës së resurseve - duke përfshirë qasjen në transport - me të cilat përballen punëtorët socialë. Ato kanë raportuar se niveli i vizitave monitoruese nga punëtorët socialë për fëmijët nga komunat tjera të vendosur tek ata ishin dukshëm më të rralla se sa ato nga punonjësit socialë nga vet QPS-të e tyre.

Grupet e fokusit me familjet strehuese të zhvilluara për këtë vlerësim gjithashtu treguan se strehuesit familjarë nuk ishin në dijeni fare për ekzistencën e planeve të shkruara të përkujdesjes për fëmijët e tyre. Ato thanë se punonjësit socialë u kanë dhënë atyre informacione me gojë dhe u kanë treguar se çfarë po ndodh me fëmijët në aspektin e progresit drejt birësimin ose kthimit në familjet e lindjes (biologjike).

Edhe më e habitshme ishte se shumica e strehuesve familjarë nuk kishin ide se ata "shqyrtohen" apo vlerësohen çdo vit nga QPS-të. Një grup i strehuesve familjarë ishin në dijeni për kërkesën që ata duhet ta kenë një kontroll vjetor shëndetësor, por nuk e dinin se punonjësit e tyre social më pas duhej ta plotësonin një formular dhe ta konfirmonin se ata ishin ende të përshtatshëm për të strehuar fëmijë.

C. 5. Mbështetja nga Amici dei Bambini

AiBi njihet nga Qeveria si partner i saj implementues për strehimin familjar. Prindërit strehues kishin një mendim shumë pozitiv për mbështetjen e ofruar nga AiBi - vizitat, trajnimet dhe këshillat nga psikologë etj. Në periudhën 2012-14 AiBi ka marrë një grant të madh nga Qeveria Italiane për ta fuqizuar sistemin e strehimit familjar, Projekti AiBi MAE (Aibi, 2014). Organizata ka ofruar trajnime për punonjësit socialë të QPS-ve dhe u ka siguruar atyre një manual dhe udhëzime për t'i orientuar ata në praktikën e tyre për strehimin familjar. AiBi po ashtu kontribuon në përpjekjet për rekrutim dhe në inkurajimin e njerëzve të cilët shprehin interesim, shpesh shokët apo familja e strehuesve ekzistues familjarë, për ta vënë veten në procedurat e miratimit nga QPS-të.

Që nga koha kur ka përfunduar projekti MAE, AiBi vazhdon të veprojë me një ekip shumë më të vogël. Megjithatë, ata vazhdojnë të ofrojnë një shumëllojshmëri të mbështetjes për strehuesit/kujdestarët; ata janë në dispozicion për këshilla me telefon; organizojnë takime të strehuesve familjarë, si për trajnim ashtu edhe për qëllime sociale. Ata po ashtu kanë rekrutuar një numër të psikologëve dhe pedagogëve me gjysëm-orari, që të jenë në dispozicion për të siguruar mbështetje të rregullt për strehuesit familjarë që ballafaqohen me sfida të veçanta. Ata kanë kërkuar për mbështetje financiare nga komunat për t'i paguar strehuesit/kujdestarët e tyre për këtë mbështetje.

MAE AiBi gjithashtu ka luajtur një rol të rëndësishëm në mbështetjen e Kolegjiut të AKK-së për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale për t'i njoftuar ata mbi rëndësinë e strehimit familjar dhe për ta përfshirë atë në kuadër të strategjisë së tyre.

Përfundim

Iniciativë e Ministrisë – një pasojë e paqëllimshme

Siç u përmend tashmë, në janar të vitit 2014 Ministria e ka lëshuar një memo për të gjitha QPS-të duke kërkuar që secila prej tyre të rekrutojë 3 familje strehuese në komunat e tyre përkatëse. Kjo dukshëm do ta rriste numrin e familjeve strehuese me rreth 100 familje, dhe do të siguronte që ka strehim familjar në çdo pjesë të Kosovës. Përfaqësuesit nga Ministria kanë shpjeguar që njëra prej arsyeve për ta kërkuar këtë ishte që secila prej komunave të mund ta ketë një familje në dispozicion për raste emergjente, përfshirë rastet në mes të natës, kur fëmijët është dashur të largohen nga prindërit në situata krize. Kohëve të fundit ka pasur një sërë rastesh ku punëtorët social dhe Policia nuk e kanë pasur asnjë vend për t'i vendosur fëmijët që janë larguar në situata emergjente.

Paralelisht me këtë memo Ministria po ashtu ka kërkuar nga Paneli i Vendosjes që mos të lejojë vendosje “ndër-komunale”; kjo do të thotë, të mos lejohet që foshnjat e braktisura (prej të cilave kanë hequr dorë prindërit) nga njëra komunë të vendosen me familje strehuese në një komunë tjetër. Ky ka qenë një plan me qëllime të mira, pasi që ata shpresuan që tani do të ketë familje strehuese në secilën komunë. Megjithatë, me dështimin e shumë komunave që realisht t’i rekrutoni 3 familje strehuese, ka pasur pasoja të paqëllimshme. Zbatimi i kësaj “rregulle” të Panelit të Vendosjes do të thotë që foshnjat nga komunat të cilat nuk i kanë familjet e veta strehuese vazhdojnë të vendosen nëpër SOS Shtëpitë e Tranzicionit, përderisa disa strehues familjarë/kujdestarë - nëpër komunat që kanë më shumë strehues familjarë sesa që kërkohet për nevojat e tyre – nuk po përdoren. Pasi që nuk doli siç u synua Ministria do të duhet ta shqyrtojë këtë politikë. Ata ka gjasa që të marrin vendim për ta përqendruar strehimin familjar në disa komuna më të mëdha të cilat do t’i shërbenin rajonit të tyre lokal. (Shih F. 2ii në vijim, f.31)

Shërbimi relativisht i vogël i strehimit familjar në Kosovë ka arritur mjaft sukses -shumë foshnjave u është ofruar kujdes familjar, në pritje të birësimit ose kthimit në familjet e lindjes (biologjike). Disa fëmijë më të rritur, dhe disa grupe me vëllezër e motra, janë vendosur tek familjet strehuese. Së paku një fëmijë me aftësi të kufizuara është nën përkujdesje afagjatë. Ekziston një kornizë pozitive e politikës dhe tani Standardet Minimale të detajuara janë krijuar për t’i udhëzuar punëtorët socialë.

Megjithatë, fuqizimi i strehimit familjar në Kosovë është një sfidë e madhe, siç shihet nga mungesa e zbatimit të memos nga Ministria. Strehimi familjar aktualisht është “duke lëvizur”. Ai nuk është duke u zhvilluar dhe zgjeruar, dhe hendeku ndërmjet politikave dhe praktikës është i madh. Ekzistojnë politika pozitive, dhe sasia e konsiderueshme e ndërtimit të kapaciteteve është zhvilluar me vite të tëra. Megjithatë kjo qëndron në kontrast me mungesën e mbështetjes financiare nga komunat, vizitat monitoruese jo të rregullta, dështimin për kompensimin e shpenzimeve shëndetësore, mungesën e rekrutimit dhe kështu me radhë. Një numër i madh i komunave thjesht nuk kanë startuar me strehimin familjar. Ekziston një vetëkënaqësi e qartë në lidhje me referimin e vazhdueshëm të fëmijëve pa përkujdesje prindërore për në shtëpinë tranzicionale për foshnja nga ana e spitalit dhe punonjësve socialë. Nëse disa faktorë të rinj nuk futen në këtë situatë, atëherë nuk ka të ngjarë që mungesa e mbështetjes e përjetuar nga strehuesit familjarë dhe AiBi do të ndryshojë. Në rekomandimet e bashkangjitura të këtij raporti do të bëhen një numër sugjerimesh rreth asaj se si të trajtohet kjo sfidë.

D. Kujdesi rezidencial (në grup të vogël)

Edhe pse strehimi familjar është fokusi kryesor i këtij raporti, pjesët tjera të sistemit të kujdesit alternativ gjithashtu janë vlerësuar në mënyrë që të kuptohet sistemi brenda të cilit vepron strehimi familjar.

Ekziston vetëm një sasi relativisht e vogël e kujdesit në grup të vogël në Kosovë dhe ai kryesisht ofrohet nga seksionet Kosovare të OJQ-ve ndërkombëtare; SOS Fshatrat e Fëmijëve, Karitas dhe Shpresë dhe Shtëpi për Fëmijë në Kosovë (e cila tashmë është plotësisht e pavarur nga OJQ-ja ndërkombëtare me të njëjtin emër). Këto shtëpi kanë mjedise fizike të cilësisë të lartë me staf të trajnuar, dhe udhëhiqen mbi baza profesionale në bashkëpunim me QPS-të.

SOS

SOS është ofruesi më i madh i përkujdesjes së fëmijëve në grupe të vogla, duke përdorur qasjen e tyre të 'përkujdesjes familjare të bazuar në komunitet', me një nënë të shtëpisë me orar të plotë e cila mbështetet nga një asistente, dhe natyrisht edhe nga struktura dhe resurset e vetë "fshatit". Këto shtëpi nuk janë më të vendosura në fshatin origjinal por janë shpërndarë nëpër pjesët e ndryshme të qytetit. Fshati vazhdon të jetë vendi i 'Shtëpisë tranzicionale afat-shkurtër dhe afat-mesme për foshnja' për 24 fëmijë, e cila është ri-organizuar në 3 shtëpi të veçanta foshnjash me nga 6 fëmijë, me një kujdestar kryesor me orar të plotë i cili mbështetet 4 asistentë, dhe një grup psiko-pedagogjik më të gjerë mbështetës.

SOS shtëpitë pothuajse plotësisht financohen nga SOS CV International, dhe ekziston gjithmonë mundësia që organizata qendrore do ta reduktojë financimin e saj dhe të kërkojë një partneritet të vazhdueshëm në të cilin qeveria paguan një pjesë të shpenzimeve.

SOS siguron një pjesë të madhe të kapaciteteve në kuadër të sektorit më të gjerë të mbrojtjes së fëmijëve. Përveç shtëpive të komunitetit, SOS drejton një numër shërbimesh, duke përfshirë një 'Projekt për mbështetje dhe këshillim të prindërve' me një staf që përfshin psikologun dhe pedagogët socialë. Ky shërbim ofron një seri të seancave këshilluese afatshkurtëra dhe të strukturuar të këshillimit dhe terapisë përmes lojës për prindërit dhe fëmijët përkatësisht. Ky shërbim ka për synim familjet në nevojë ku mund të ekzistojë rreziku i abuzimit, neglizhencës, zhvillimit të vonshëm të fëmijës, dhe ndarjes së familjes. Referimet pranohen nga QPS-të apo dikund tjetër. SOS gjithashtu drejton një numër të projekteve të bazuara në komunitet që kanë për synim ofrimin e aktiviteteve për fuqizimin e familjes, për familjet e varfëra dhe të rrezikuara. SOS gjithashtu luan një rol aktiv në avokim si pjesë e koalicionit KOMF.

CARITAS

CARITAS është një agjenci për shërbime sociale dhe të komunitetit e Kishës Katolike. Ajo vepron në shumë pjesë të Kosovës, me një sistem të vullnetarëve të bazuar në famulli që ofrojnë aktivitete rinore dhe të komunitetit. Që nga përfundimi i konfliktit, me ndihmën e Caritas Umbria (Itali) ata gjithashtu kanë menaxhuar një shtëpi rezidenciale, të drejtuar si një model i 'shtëpisë familjare në grup' me një menaxher të shtëpisë, Z. Massimo Mazzali, i cili jeton aty me familjen e tij. Ata mbështeten nga një ekip i vogël i kujdestarëve dhe pedagogëve; disa prej tyre të punësuar dhe disa vullnetarë nga Italia. Shtëpia ishte më parë në qytetin e Klinës dhe tani është e vendosur në një ndërtesë të re në fshat, disa kilometra nga Klina. Massimo dhe ekipi i tij i përkujdesjes mbajnë lidhje me punëtorët socialë

për të gjithë fëmijët, dhe mbajnë vizita të rregullta nëpër shtëpi, si dhe vizita nga prindërit, varësisht nga këshillat e punëtorëve socialë. Shtëpia kryesisht u shërben fëmijëve nga zona përreth, dhe mbulon disa komuna. Kjo shtëpi financohet nga Caritas Umbria, i cili gjithashtu inkurajon dhe mbështet rekrutimin e vullnetarëve që mund të qëndrojnë në shtëpi për një vit ose dy.

Shtëpia gjendet në një mjedis të bukur, duke iu ofruar shumë mundësi fëmijëve që të lozin në fusha dhe shtigje. Edhe pse shtëpia gjendet disa kilometra nga qyteti, ata bëjnë përpjekje të konsiderueshme për t'i integruar fëmijët me fqinjët e pakët në afërsi dhe me qytetin. Fëmijët ndjekin shkollën në qytet dhe shpesh marrin pjesë në aktivitete atje, ndërsa miqtë e tyre janë të mirëpritur në shtëpi. Shtëpia e Caritas po ashtu ka ndërmarrë programe mbështetëse për fëmijët që largohen nga kujdesi. Ata kanë gjetur punë për disa nga të rinjtë më të rritur në moshë kur janë larguar nga shtëpia, dhe ata gjithashtu kanë mbështetur arsimimin e atyre që kanë shkuar në kolegji. Ata gjithashtu i mirëpresin të larguarit nga përkujdesja që përsëri të kthehen dhe të qëndrojnë me ta gjatë festave, pushimeve, etj.

Shpresa dhe Shtëpitë për Fëmijë në Kosovë

Shpresa dhe Shtëpitë për Fëmijë është një OJQ lokale, e cila varet shumë nga mbështetja financiare prej qeverisë, e cila e mbulon vetëm një pjesë të shpenzimeve të veprimtarisë, dhe duhet të plotësohet me donacione nga burimet lokale. Qeveria kohët e fundit e ka reduktuar financimin dhe ka kërkuar që OJQ-ja të gjejë burime të tjera të financimit të cilat ata do t'i përmbushin. Si një shërbim lokal, Shpresa dhe Shtëpitë luan një rol shumë të rëndësishëm në ofrimin e shërbimeve në vend dhe kjo duhet të jetë prioritet që financat e saj të vihen në një pozitë të sigurtë. Ajo është po ashtu më 'autoktonja' prej shërbimeve rezidenciale në kuptimin që ajo nuk financohet nga ndonjë OJQ ndërkombëtare. Ajo ka vazhduar të zhvillojë shërbimet e saj dhe ka një fokus të veçantë mbi kujdesin për fëmijët më të rritur në moshë. Adresa e saj nuk reklamohet gjerësisht dhe ajo ka mundësi të përdoret si një 'shtëpi e sigurt' për fëmijë në rrezik nga trafikimi apo shfrytëzimi seksual.

Është e rëndësishme të përkujtojmë se një sistem i suksesshëm i strehimit familjar duhet të ketë shërbime rezidenciale për të vepruar si një resurs dhe si rezervë. Në vendet me sisteme të zhvilluara dhe të gjera të strehimit familjar, ka gjithmonë një numër të dështimeve në vendosjen e fëmijëve në strehim familjar; shpesh të paplanifikuara. Po ashtu ka edhe 'ndërprerje' të planifikuara; kur vendosja nuk funksionon. Në këto situata fëmijët më të rritur në moshë nganjëherë më mirë vendosen në një shtëpi të vogël rezidenciale. Ekspertiza në dispozicion në shtëpitë rezidenciale dhe organizata mund të jetë shumë e dobishme për mbështetjen e familjeve strehuese dhe punëtorët socialë, dhe shpesh mund të përfitohet shumë nga trajnimet e përbashkëta dhe mbështetja reciproke. Meqë përkujdesja rezidenciale është reduktuar në disa vende, atëherë kjo përkujdesje tenton të fokusohet në ofrimin e kujdesit të fëmijëve në grup të vogël, të përkujdesjes familjare për fëmijët më të rritur në moshë dhe më të cenueshëm apo të trazuar, dhe për ata fëmijë të cilët për çfarëdo arsye nuk e kanë të lehtë apo të mundur që të vendosen në një mjedis familjar.

Nëse Kosova është në gjendje ta shtojë numrin e familjeve strehuese dhe të zgjerojë kategoritë e fëmijëve nën përkujdesje, atëherë roli i shtëpive të familjeve në grup do të ndryshojë dhe ndoshta do të fokusohen tek fëmijët dhe të rinjtë më të rrezikuar dhe më sfidues.

E. Largimi nga kujdesi

Gjithnjë e më shumë po pranohet se 'të larguarit nga kujdesi', ata të rritur të rinj që janë larguar nga kujdesi kohëve të fundit, për shembull të moshës 18-25 vjeç, janë veçanërisht të rrezikuar nga tranzicionet e vështira për në moshën e rritur dhe nga 'rezultatet e dobëta' në aspektin e papunësisë, vetë-kujdesit, problemeve të shëndetit mendor, izolimit social dhe të rrezikuarit nga krimi, shtatzania e hershme, etj. Si rezultat, nevojat dhe të drejtat e të larguarve nga kujdesi janë përfshirë në Udhëzimet e OKB-së, dhe të drejta dhe shërbime të reja mbështetëse janë në zhvillim e sipër në një numër gjithnjë në rritje të vendeve (Quinn et al., 2014). Është e rëndësishme të pranojmë se jo të gjithë të larguarit nga kujdesi kanë probleme serioze, por ata përballen me sfida të mëdha.

Legjislacioni i Kosovës që rregullon zhvillimin e të drejtave të fëmijëve dhe shërbimeve sociale është përgatitur viteve të fundit dhe mbështetet fuqishëm nga KNDF dhe Udhëzimet e OKB-së për Kujdesin Alternativ të Fëmijëve. Megjithatë, të drejtat e të larguarve nga kujdesi përbëjnë një boshllëk dhe dobësi të madhe në legjislacion - ato thjeshtë mungojnë nga legjislacioni, dhe ka pak shenja të ndonjë përqendrimi të vëmendjes tek të larguarit nga kujdesi në punën e Ministrisë apo QPS-ve.

Numri i 'të larguarve nga kujdesi' në çfardo kohe mund të jetë relativisht i vogël. Siç e kemi vërejtur, foshnjat e braktisura përbëjnë përqindjen më të madhe të atyre fëmijëve që hyjnë nën përkujdesje, dhe shumë prej tyre shkojnë në birësim; qoftë brenda apo jashtë vendit. Çështja e largimit nga kujdesi nuk është shfaqur shpesh në lidhje me strehimin familjar deri më tani. Kjo është një çështje që është hasur në lidhje me opsionet e ndryshme rezidenciale. Rrjedhimisht shërbimet e ofruara nga këto organizata - sidomos nga SOS, që përbën shërbimet formale të largimit nga kujdesi të cilat ekzistojnë në këtë moment në Kosovë. Rreth 20 të rinj janë duke përfutur nga programet Rinore të SOS dhe shërbimet pas largimit.

Shërbimet për të larguarit nga kujdesi në Kosovë

SOS-i ndërkombëtarisht ka zhvilluar një sistem të strukturuar të lëvizjes nga shtëpia e të rinjve, për në jetesë gjysmë të pavarur dhe më në fund në 'pavarësinë e mbështetur' që mbulon grupmoshën 18-25 vjeç. Gjatë kësaj kohe SOS ofron ndihmë financiare dhe asistencë personale dhe ndihmon të rinjtë me arsimim dhe punësim. Ky sistem është duke u implementuar në SOS Kosovë. Një program në shkallë më të vogël dhe më pak i strukturuar i asistencës përcjellëse është duke u ofruar edhe nga Caritas-i për disa nga të larguarit e tij nga kujdesi të cilët mbesin në qytetet më afër shtëpisë.

Udhëzimet e OKB-së e pranojnë faktin se të rinjtë me nevoja të veçanta do të kërkojnë asistencë për t'u siguruar që kanë mundësi për integrim dhe strehim e mbështetje jo-institucionale. Siç u përmend më lart (f. 19) në të dhënat për numrin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në shtëpinë rezidenciale në Shtime, një numër i të rinjve janë në fakt mbi 18 vjeç, dhe ende nuk është gjetur akomodim i përshtatshëm për ta, gjë që tregon se atje ka nevojë për punë urgjente që duhet të bëhet për t'i ndihmuar ata me tranzicionet e tyre.

Zhvillimi i politikave dhe pjesëmarrja

'Largimi nga kujdesi' në fakt më mirë përshkruhet si një tranzicion. Mosha 18-vjeçare shënon fundin zyrtar të fëmijërisë, në të drejtën ndërkombëtare dhe në aspektin kulturor në shumë pjesë të botës. Shërbimet e mirëqenies së fëmijëve shpesh janë

ndalur në atë moshë, veçanërisht ato të ofruara nga organet shtetërore, qoftë në strehim familjar apo kujdes rezidencial. Megjithatë, ka pak të rritur të rinj në popullatën e gjerë që duhet të mbijetojnë vetë në moshën 18 vjeçare, dhe shumica mbesin me prindërit e tyre deri në martesë. Ndërsa edhe ata që mund të shkojnë në kolegji apo universitet dhe zgjedhin të qëndrojnë në një formë të jetesës 'së pavarur' zakonisht do të jenë në gjendje të kthehen në shtëpi kurdo që ata dëshirojnë dhe marrin një mirëseardhje, dhe ndihmë praktikë. Opsionet e tilla 'të kthimit në shtëpi' nuk janë zakonisht në dispozicion për të rinjtë që janë larguar nga kujdesi alternativ. Sfidat me të cilat ata përballen janë shumë më të vështira se ato të një të riu të rëndomtë, duke qenë se kanë kaluar një kohë të konsiderueshme në kujdes alternativ - që sipas definicionit përfshin një shkallë të konsiderueshme të humbjes së marrëdhënieve të ngushta me prindërit, dhe shpesh edhe me familjen e gjerë të lindjes. Hulumtimet nëpër kultura të ndryshme tregojnë se izolimi social dhe vetmia e dukshme janë ndër karakteristikat kryesore të jetës për shumë të rinj të larguar nga kujdesi

(Quinn et al., 2014). Detyra e shërbimeve sociale për të siguruar mbështetje në strehim, trajnim dhe punësim si dhe për të ndërtuar rrjete sociale është pasqyruar në Udhëzimet e OKB për Kujdesin Alternativ për Fëmijë – paragrafet 131-136 e adresojnë këtë aspekt të kujdesit, si dhe manuali i zbatimit (Cantwell et al., 2012) i plotëson Udhëzimet me politika dhe këshilla praktike.

Duke njohur këto dobësi dhe 'rezultatet e dobëta' për shumë të larguar nga kujdesi janë bërë përpjekje për të ofruar shërbime, nga qeveritë, OJQ-të dhe organizatat e shoqërisë civile. SOS Fshatrat e Fëmijëve është një nga OJQ-të e cila ka investuar shumë punë në këtë fushë në vitet e fundit, duke fokusuar politikat e saja dhe zhvillimin e shërbimeve në një program thelbësor të hulumtit të ndërsjellë (SOS Fshatrat e Fëmijëve, 2012). Në Maqedoni, Qeveria e ka miratuar kohëve të fundit një pagesë për largimin nga kujdesi prej 3000€ për të larguarit nga kujdesi, në mënyrë që t'u ndihmohet atyre që të kujdesen për veten dhe që të paguajnë për akomodim.

Ekziston një nevojë urgjente për të adresuar këtë boshllëk të politikave dhe shërbimeve për të rinjtë me aftësi të kufizuara dhe pa aftësi të kufizuara që përjetojnë tranzicionin nga përkujdesja në Kosovë. Kjo kërkon veprim në një numër fushash; legjislacioni dhe zhvillimi i politikave, zhvillimi i praktikave dhe krijimi i shërbimeve të reja mbështetëse.

Të larguarit nga kujdesi janë gjithashtu një grup të cilët mund të flasin për veten e tyre nëse u jepen mundësitë, inkurajim dhe forume, dhe krijimi i mundësive të tilla është një aspekt kyç i pjesëmarrjes që mund të ndihmojnë në lëvizjen përpara të agjendave të ndryshme. Do të ishte e rëndësishme për të gjithë akterët në fushën e shërbimeve sociale që të bëhen bashkë në krijimin e disa forumeve ku mund të artikulohen storië e të larguarve nga kujdesi. Kur profesionistët dhe politikanët dëgjojnë historitë individuale të betejave me të cilat ballafaqohen shumë të rinj, kjo është zakonisht një nxitje e fuqishme për të reaguar.

F. 1. Fëmijët dhe sistemi i kujdesit në Kosovë

Gjatë shqyrtimit të sistemit të kujdesit alternativ në Kosovë, është i dukshëm numri i ulët i fëmijëve në kujdesin alternativ dhe fakti se mbi 75% e vendosjeve të tilla janë të strehuar tek kujdestarët nga farefisi. Megjithatë, sasia dhe cilësia e të dhënave në lidhje me këta fëmijë që i ka Ministria është shumë e kufizuar, dhe mezi shtrihet përtej numrave total të fëmijëve sipas llojit të vendosjes. Nuk ka të dhëna të disponueshme për profilin e fëmijëve; mosha, gjinia, periudha kohore e qëndrimit në kujdes, arsyet për hyrje në kujdes, etj. Një fakt tjetër i habitshëm dhe pozitiv është se Kosova, ndryshe nga shumica e fqinjëve të saj në rajon, nuk ka ndonjë institucion të shkallës së gjerë. Të gjitha qendrat aktuale që përdoren për banim janë në shkallë të vogël dhe janë themeluar kohëve të fundit.

Ky profil mund të shihet si shumë i favorshëm, dhe sigurisht është një pasqyrë që përputhet me preferencat e politikave të shprehura në Udhëzimet e OKB-së; ku gati të gjithë fëmijët janë në forma të ndryshme të kujdesit të bazuar në familje apo përkujdesje rezidenciale në shkallë të vogël, dhe përdorimin e gjerë të kujdesit në farefisi. Megjithatë, vlera e përfitimeve në të holla në dispozicion për familjet e varfra janë të ulëta. Ka varfëri mjaft të përhapur dhe nivele të larta të papunësisë. Shumë familje me siguri janë nën presion dhe disa prej tyre janë duke pranuar asistencë nga OJQ-të e ndryshme siç është përmendur në këtë raport. Disa familje dhe fëmijë mund padyshim të përfitojnë nga normat më të larta të të ardhurave në para dhe format tjera të mbështetjes familjare, por është një fakt i mirëpritur që varfëria në vetvete nuk çon në nivele të larta të hyrjes në kujdes alternativ.

Megjithatë, shumë raporte, përfshirë edhe raportin e UNICEF-it të Hartëzimit dhe Vlerësimit (UNICEF, 2012), dhe të intervistuarit për këtë raport - duke përfshirë edhe Drejtorët e QPS-ve – sugjerojnë se QPS-të nuk janë në gjendje të kryejnë shumë punë proaktive apo parandaluese. Në të vërtetë, fëmijët janë duke kërkuar lemshë dhe duke punuar nëpër rrugë, dhe OJQ-të lokale dhe ndërkombëtare janë duke mbështetur në mënyrë aktive familjet e varfëra përmes një shumëllojshmërie të masave mbështetëse për familje. Shërbimet e tilla padyshim se kontribuojnë në reduktimin e numrit të fëmijëve të cilët përndryshe mund të futen në kujdes alternativ. Pakicat Rome, Ashkali dhe Egjiptiane i kanë të njëjtat të drejta sikurse të gjithë kosovarët por mund të jetë veçanërisht e vështirë të arrihen. Ndërtimi i besimit dhe përkushtimit me këto komunitete nga QPS-të është një sfidë e madhe.

Është gjithashtu e rëndësishme të theksohet se një pjesë e madhe e sistemit aktual është e udhëhequr nga ofrimi i kujdesit - afatshkurtër dhe afatgjatë - për foshnjat e braktisura. Për më tepër, shumë prej këtyre foshnjave vazhdojnë të strehohen në 'shtëpinë tranzicionale' të SOS e jo në familje strehuese.

Strehimi familjar në Kosovë është i themeluar në mënyrë të vendosur dhe mund të zgjerohet; a) në numrin e përgjithshëm të familjeve strehuese, dhe b) në nivelin e fëmijëve të vendosur me strehues familjar. Fëmijët më të rritur në moshë që vuajnë nga abuzimet apo neglizhenca në familjet e tyre, mund të strehohen, duke i përfshirë edhe ata nga grupet e pakicave siç janë komunitetet Romë, Ashkali dhe Egjiptiane. Është jo reale të pritet që secila komunë ta zhvillojë një game të gjerë të opsioneve të strehimit familjar; por disa mund t'i zhvillojnë shërbimet e specializuara; për shembull shërbime lehtësimi për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Përqindja e fëmijëve në kujdesin alternativ

Numri i fëmijëve të moshës 0-18 vjeçare në Kosovë është regjistruar si 592,046 në regjistrimin e vitit 2012. Duke përdorur shifrën e 752 fëmijëve nga tabela 1 më sipër, kjo jep një proporcion prej 0.13% (1.3 në 1,000) të fëmijëve në kujdes alternativ, nga të cilët 78% (0.3 në 1000) janë në strehim tek farefisi, 68 fëmijë nën kujdes të familjeve strehuese janë rreth 10% (rreth 0.03 në 1000) dhe 94 në përkujdesje rezidenciale janë rreth 12% (rreth 0.12 në 1000). Kjo është një përqindje shumë e ulët e fëmijëve që jetojnë nën përkujdesje.

Në Maqedoni, sipas bazës së të dhënave TransMonEE (Monitorimi Transformues për Barazi të Shtuar, UNICEF) shifrat për Maqedoni; në vitin 2013 ky vend kishte 0.6 në 1,000 fëmijë në përkujdesje rezidenciale, dhe 1.6 fëmijë në 1,000 në strehim familjar dhe nën kujdestari.

Në Serbi, sipas bazës së të dhënave TransMONEE; në vitin 2013 Serbia kishte 1.6 në 1,000 fëmijë në përkujdesje rezidenciale, dhe 14.8 fëmijë në strehim familjar dhe nën kujdestari.

Ky krahasim tregon se Maqedonia ka ndoshta 5 herë më shumë fëmijë nën përkujdesje se sa Kosova, dhe Serbia shumë herë më shumë se kjo.*

* Duhet të kihet kujdes i madh kur krahasohen të dhënat nga llojet e ndryshme të burimeve. Të dhënat për Kosovën në tre vitet e fundit janë siguruar për TransMONEE nga Agjencia e Statistikave të Kosovës por ende nuk janë raportuar në tabelat e tyre vjetore. Përkufizimet e strehimit familjar (nëse e përfshin kujdesin farefisnor apo jo) dhe përdorimi i kujdestarisë formale mund të ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme ndërmjet vendeve.

Megjithatë, Ministria në Kosovë ka njohuri të mira për numrin e përgjithshëm të fëmijëve në kategori të ndryshme dhe është e sigurt të thuhet se Kosova në përgjithësi ka pak fëmijë në përkujdesje rezidenciale apo familjare.

F. 2. Fuqizimi i Strehimit familjar

Strehimi familjar mund të ofrohet vetëm kur ai është pjesë e një sistemi më të gjerë të mbrojtjes dhe kujdesit që përfshin një theks të veçantë në fuqizimin e familjes dhe ofron një gamë të gjerë zgjedhjesh të kujdesit alternativ për fëmijët

(Familje për Çdo Fëmijë, 2014, f.6)

F. 2.1. QPS-të dhe strehimi familjar

Zhvillimi i strehimit familjar në Kosovë është një detyrë jetike për shkak se këto vendosje menaxhohen dhe financohen më drejtpërdrejtë nga Qeveria, se sa nga OJQ-të ndërkombëtare. Kryesore në lidhje me këtë është rritja e angazhimit të QPS-ve rreth strehimit familjar. Me rritjen e numrit të strehuesve familjar, me rritjen e angazhimit të QPS-ve rreth strehuesve familjar, dhe me rritjen e kontributit të Ministrisë në buxhetin e shërbimeve të specializuara mbështetëse në nivel qendror, Kosova do të fillojë të zhvillojë kujdesin e vet alternativ të bazuar në familje. Duke bërë këtë ajo do të jetë në një pozicion shumë më të fortë për të arritur aspiratat e saja në përmbushjen e standardeve ndërkombëtare dhe implementimin e legjislacionit dhe udhëzimeve të veta.

Për fat të keq, ka dëshmi se punonjësit socialë të punësuar në QPS-të nuk janë duke i kryer detyrat e tyre sipas manualit të procedurave (2002) dhe legjislacionit dhe udhëzimeve pasuese; në lidhje me vizitat e rregullta monitoruese, apo vlerësimet të planeve të përkujdesjes, etj. Duke pasur parasysh këtë historik, implementimi i Standardeve Minimale të Sherbimeve Sociale të miratuara së fundi ka të ngjarë të jetë sfidues. Strehuesit familjarë dhe AiBi raportojnë se vizitat monitoruese shpesh shtyhen dhe në disa raste nuk ndodhin për disa muaj. E njëjta gjë ndodh me foshnjat e strehuara në SOS Shtëpitë Tranzicionale. Siç është cekur më herët, edhe pse ekziston një strukturë e krijuar mirë e Qendrave për Punë Sociale në çdo pjesë të Kosovës, prap numri i punëtorëve social është i ulët dhe gama e detyrave të tyre është e gjerë. Kur i shtojmë kësaj edhe mungesën e buxhetit, atëherë ndoshta nuk është për t'u habitur që punonjësit socialë në shumë vende kanë vështirësi për të implementuar llojet e praktikave të menaxhimit të rasteve që parashihen në manualin e 'Procedurave të vendosjes së fëmijëve në kujdesin alternativ'.

Strehuesit familjarë në dy prej komunave të konsultuara për këtë raport, kishin mendime përgjithësisht pozitive për punonjësit e tyre social. Në të vërtetë, ata duket sikur kishin simpati të madhe për ta në aspektin e mungesës së resurseve - madje edhe qasjes në transport për vizita monitoruese apo termine në spital për fëmijët e strehuar. Strehuesit familjarë raportuan se niveli i vizitave monitoruese nga punëtorët social për fëmijët nga komunat tjera ishin dukshëm më pak të shpeshta se sa ato nga punonjësit socialë të QPS-ve të tyre kur ata i strehojnë fëmijët nga një komunë tjetër.

Është veçanërisht zhgënjyese që QPS-ja në Prishtinë- dukshëm komuna më e madhe - deri më tani ka arritur të rekrutojë vetëm një familje strehuese. Spitali kryesor është në Prishtinë dhe është vendi ku numri më i madh i foshnjave të braktisura pranohen në përkujdesje. Drejtori i QPS-së në intervistë ka thënë se niveli i pagesës është shumë i ulët për të tërhequr ndonjë interesim. Ai njofton se ka kërkuar nga financat e DShMS-së që për vitin e ardhshëm të paguajnë 100€ shtesë në muaj (ashtu siç kanë bërë 2 komuna të tjera). Ai tha se janë 4 familje që kanë shprehur interesim për t'u bërë familje strehuese dhe ai beson se nëse ai do të ketë sukses në marrjen e parave shtesë, atëherë ai do të jetë në gjendje t'i rekrutojë ato.

F.2.2. Një 'Plan B' për fuqizimin e strukturës së QPS-së rreth strehimit familjar

Deri më tani Ministria ka nxjerrë udhëzime mbi supozimin se të gjitha QPS-të do të rekrutojnë, përkrahin dhe mbikëqyrin strehuesit familjarë, por siç e kemi parë ato janë funksionale vetëm në rreth gjysmën e komunave dhe numri ka ndryshuar fare pak në vitet e fundit. Strehimi familjar është një shërbim i specializuar i punës sociale dhe ndoshta tani është koha të pranojmë faktin se do të jetë e vështirë të arrijmë që të gjitha QPS-të të zhvillojnë ekspertizën e nevojshme për të shfrytëzuar më mirë strehimin familjar. Një strategji alternative mund të jetë identifikimi i ndoshta 9-12 komunave 'Udhërrëfyese' të cilat mund të veprojnë si 'qendra të strehimit familjar', duke i shërbyer zonave më të gjera, ndoshta duke mbuluar 3 ose 4 komuna.

Është e qartë se kjo do t'i fuste ata në më shumë shpenzime dhe do të kërkonte më shumë personel. Por ndoshta kjo është rruga që do t'u mundësojë disa punëtorëve socialë - ndoshta njërit në secilën nga këto 'komuna qendër' që të zhvillojnë besim dhe ekspertizë të vërtetë në menaxhimin e strehimit familjar. Kjo është ndoshta më realiste se sa të kërkohet nga secila prej 38 komunave, disa prej tyre me pop-

ullsi shumë të vogël, që të zhvillojnë shërbimet e tyre.

Për ta lehtësuar këtë zhvillim të shërbimeve, komunat të cilat bëhen “udhërrëfyese” apo qendra të strehimit familjar duhet të marrin një nivel më të lartë të buxhetit të QPS-ve për përkujdesje se sa të tjerat. Një diferencim i tillë i buxhetit (në mënyrë të përshtatshme) do të veprojë si një nxitje për komunat që të marrin udhëheqjen në këto fusha. Kjo gjithashtu do të thotë se ato komuna që nuk kanë strehues familjarë të tyre nuk do të ndëshkohen për mos rekrutimin e strehuesve të tyre dhe ata nuk do të ngarkohen për përdorimin e këtyre vendosjeve ‘ndërmjet-autoriteteve’. Është e qartë që nga ata ende pritet të kryejnë vizita monitoruese kur kanë një fëmijë të vendosur në komunën fqinje.

F. 2.3. Mbështetja financiare për strehuesit familjarë

Drejtorët e punës sociale dhe përfaqësues të OJQ-ve sugjerojnë që niveli aktual i pagesave nuk inkurajon shumë njerëz që të mendojnë për t’u bërë strehues familjarë. Duket e mundshme që në situatën aktuale ekonomike rritja e shumës do të tërheqë jo vetëm një grup më të gjerë të interesit por do të jetë gjithashtu një sinjal për statusin e lartë të rolit. Duhet të theksohet se shifra bazë prej 150€ është shumë më e lartë se sa nivelet aktuale të pagesave të asistencës sociale të paguara nga qeveria për familjet e varfëra. Duke pasur parasysh rolin e tyre profesional në përkujdesjen për fëmijët, të paguarit e strehuesve familjarë më shumë se kostot e drejtpërdrejta të shpenzimeve për ushqim, veshmbathje, banim, shkollim dhe shëndet të fëmijës, është plotësisht e drejtë. Strehuesit familjarë paguhen vetëm kur ata kanë fëmijë, dhe ata i nënshtrohen vlerësimit vjetor, dhe mund të hiqen nga shërbimi nëse kujdesi që ata ofrojnë nuk konsiderohet i kënaqshëm. Ata janë pra nën mbikëqyrje, nga ata pritet të marrin pjesë në trajnime, dhe gjithashtu pritet që të bashkëpunojnë me profesionistë të tjerë të përfshirë në kujdesin e fëmijëve. Është një rol i rëndësishëm, edukues dhe profesional, dhe duhet të tërheqë njohjen e duhur financiare.

Disa komuna kanë gjetur tashmë fonde për të paguar 100€ shtesë për muaj, dhe të tjerat qartazi janë duke menduar në këtë mënyrë. Siç tregon ky raport një sërë veprimesh janë të nevojshme për ta fuqizuar shërbimin e strehimit familjar, por ndoshta më themelore prej të gjithave është niveli i pagesave, dhe gjetja e një mënyrë efektive për t’i kompensuar shpenzimet për shëndetin e fëmijëve. Është gjithashtu e rëndësishme të ofrohet një lloj i pagesave të ndërlidhura me moshën. Shumica e njerëzve do të pranonin se shpenzimet reale të rritjes së një adoleshenti janë më të larta se për një foshnje apo një fëmijë të vogël, dhe pagesa për strehimin familjar duhet të reflektojë këto realitete. Mund të jetë më e lehtë të mbështetet një rritje thelbësore e pagesave nëse ato konsiderohet se përbëhen prej dy elementeve; 1. ‘kostot e drejtpërdrejta’ të fëmijëve dhe 2. ‘pagesa për kujdestarët’. Një numër i masave specifike janë propozuar në Rekomandimin 2 të këtij raporti.

F. 2.4. Puna në partneritet me punonjësit socialë të QPS-ve

Konsultimi për këtë raport gjithashtu zbuloi se strehuesit familjarë nuk ishin në dijeni fare për ekzistencën e planeve individuale të përkujdesjes për fëmijët e tyre. Ata thanë se punonjësit socialë u kanë dhënë atyre informacione me gojë dhe u kanë treguar se çfarë po ndodhte me fëmijët në aspektin e progresit të tyre, ose drejt birësimit të tyre - ose rreth kthimit në familjet biologjike, për ata fëmijë të vendosur tek strehuesit familjarë për shkak të abuzimit apo neglizhencës.

Edhe më e habitshme ishte se shumica e familjeve strehuese nuk kishte asnjë ide se ata ‘rishikoheshin’ apo vlerësoheshin në baza vjetore. Një grup ishin në dijeni të kërkesave që ata të kenë një kontroll vjetor shëndetësor, por nuk e dinin se punonjësit e tyre socialë duhej të plotësonin një formular dhe të konfirmojnë se ata ishin

ende të përshtatshëm për të strehuar.

F. 2.5. Mbështetja e specializuar për strehuesit familjarë

Për momentin AiBi siguron pjesën më të madhe të mbështetjes së përditshme për strehuesit familjarë. Ata gjithashtu sigurojnë takime të rregullta sociale dhe edukative për strehuesit familjar. Nëse Ministria do të marrë më shumë përgjegjësi për vendosjet, atëherë është me rëndësi që të fillojë të marrë përgjegjësinë për shërbimin mbështetës. Ministria mund për shembull, të mbulojë shpenzimet e shërbimit mbështetës nga AiBi përmes një MOU (Memorandum i Mirëkuptimit). Një aranzhim i tillë mund të mbulojë pagën dhe shpenzimet operative (duke e përfshirë edhe udhëtimin) për një apo dy punëtorë socialë apo psikologë – që veprojnë së punëtorë mbështetës dhe zhvillimor për strehuesit familjarë. Roli i tyre – kudo të vendosur apo të mbikqyrur – do të jetë t'i fuqizojnë shërbimet mbështetëse për strehuesit familjarë përtej asaj që mund të ofrohet nga cilado komunë. SOS po ashtu ka personel (staf) të trajnuar dhe me përvojë të cilët do të mund të ofrojnë mbështetje për strehuesit familjarë, dhe nëse strehimi familjar zgjerohet atëherë do të jetë me rëndësi të përdoren të gjitha burimet në dispozicion për mbështetje dhe ekspertizë.

F. 3. Statusi ligjor dhe çështjet e birësimit

Ky vlerësim nuk ka përfshirë ndonjë përqendrim mbi birësimin dhe çështjet ligjore që lidhen me të. Megjithatë, do të përmendet këtu pasi që ai ka ndikim në funksionimin e sistemit të strehimit familjar, i cili përdoret kryesisht për përkujdesje të përkohshme për foshnjat nga të cilat është hequr dorë.

Procesi i ngadalshëm për zgjidhjen e statusit ligjor të foshnjave nga të cilat është hequr dorë është një shqetësim i madh për kujdestarët dhe avokatët, dhe informacioni për këtë vlerësim është mbledhur nga Drejtoresha e KOMF-it dhe është konfirmuar në një intervistë me njërin prej Drejtorëve të QPS-ve. Tema ka qenë përqendrimi i shqyrtimit të hollësishëm në raportin Më Ço në Shtëpi (KOMF, 2014) edhe pse duhet të theksohet se Ministria konteston disa prej gjetjeve në këtë raport, veçanërisht sa i përket gjoja mungesës së qartësisë në lidhje me rolin dhe fuqitë e Panelit të Vendosjes duke iu referuar statusit ligjor të aplikacioneve. Koha e gjatë që merr procesi i birësimit do të thotë se disa fëmijë mund të mbesin me prindërit strehues për më shumë se një vit përpara se të vendosen tek prindërit birësues, dhe deri në atë kohë ka shumë gjasa që ata do të kenë formuar lidhje të forta me strehuesit familjarë, gjë që e bënë transferimin shumë të vështirë.

Natyrisht, kjo është një fushë në të cilën është e vështirë të arrihet balanci i duhur. Është e rëndësishme që punonjësit socialë të kërkojnë të bindin nënën që ta marrë fëmijën prapa dhe t'i ofrojnë asaj mbështetje për ta bërë këtë. Megjithatë, nëse nëna është e sigurt në mendjen e saj, atëherë duhet të jetë e mundur të ndiqet procesi i duhur për çështje muajsh, nëse nevojat dhe të drejtat e fëmijës mbahen në qendër të vëmendjes.

Njëra çështje është fakti që nuk ka Gjykata të dedikuara që të merren vetëm me çështjet civile. Problemi duket të jetë i përqëndruar në dy aspekte të praktikës që përfshijn detyra të rëndësishme dhe sfiduese, të cilat ndërmerren nga punonjësit socialë dhe Gjykatat. Statusi i fëmijës si 'i braktisur' duhet të përcaktohet para se fëmija të mund të birësohet. Ka dy fusha të praktikës të cilat janë identifikuar si problematike:

- a) Të kuptuarit nga punonjësit socialë dhe menaxherët e tyre rreth asaj se çfarë përbën një praktikë të mirë në aspektin e lejimit të kohës së mjaftueshme për nënat që të mendohen mirë për vendimin e tyre për të hequr dorë nga fëmija. Në shumë QPS duket sikur si pikë referimi për arritjen e kësaj shkalle të sigurisë është marrja e deklaratës nga nëna (që ajo dëshiron të heqë dorë nga fëmija i saj) në 3 raste të ndara, gjatë një minimumi prej 6 muajsh, para se të fillojnë me përgatitjen e dokumenteve për Gjykatat.
- b) Mungesa e qartësisë në mes gjykatave dhe QPS-ve në lidhje me cilësinë e raportit me shkrim që kërkohet në mënyrë që gjyqtarët të marrin vendimin. Me pak fjalë, dokumentet shpesh iu kthehen punëtorëve socialë mbi bazën se ato nuk janë të plota.

Ekziston një fushë e procesit që gjithashtu duket sikur kontribuon në vonesa dhe në paqartësi:

- a) Roli i Pnelit për Vendosjen e Fëmijëve nuk është i qartë. Duket se në çdo rast në fakt punonjësi social dërgon dokumentet e birësimit tek paneli që ata t'i shqyrtojnë. Dokumentet më pas i kthehen punëtorit social, i cili pastaj ia përcjellë ato gjykatave.

Raporti Më Ço në Shtëpi shqyrton këtë proces deri diku në detaje dhe thekson se ka pasiguri reale rreth qëllimit të kësaj pjese të procesit: a duhet Paneli ta këshillojë punëtorin social në lidhje me raportin, duke përfshirë dhënien e këshillave në lidhje me cilësinë e dokumenteve; a është duke e dhënë rekomandimin vendimtar për Gjykatën që paneli e mbështet kërkesën, apo diçka tjetër? Nivelet e ndryshme në proces duhet të qartësohen për të gjithë ata që janë të përfshirë. Ministria është përgjigjur në këtë pikë dhe thotë se 'roli i panelit është shumë i qartë' dhe i bazuar në legjislacion. Pozita legjislative me siguri që është e qartë në letër por siç duket është më pak e qartë në praktikë.

Kjo është një fushë komplekse e praktikës së punës sociale, dhe ka një numër të rrjedhave të mundshme të veprimit. Këto kërkojnë ngritjen e një niveli më të lartë të ekspertizës për punë sociale se që ndoshta është në dispozicion në Kosovë për momentin. Disa vende, përfshirë Mbretërinë e Bashkuar, kanë zhvilluar qasje të «planifikimit paralel» ku punëtorët socialë bëjnë përgatitjet për birësim, dhe njëherazi mundësojnë që të jepet kohë për punë me familjen biologjike që mund të rezultojë me vlerësimin që birësimi është i panevojshëm. Po ashtu ka pasur përpjekje për t'i rekrutuar prindërit e ardhshëm birësues të cilët janë të gatshëm të marrin fëmijën mbi një bazë të strehimit familjar si fillim.

F. 4. Menaxhimi i përmirësuar i kujdesit për të porsalindurit e braktisur

Vazhdimi i vendosjes së një numri të konsiderueshëm të foshnjave nga të cilat kanë hequr dorë në SOS shtëpinë tranzicionale nuk është në përputhje me interesat më të mira të fëmijëve dhe me miratimin e fushatës 0-3 të UNICEF-it nga ana e qeverive në rajon. Kjo fushatë kërkon përkushtim nga qeveritë dhe shërbimet sociale që të gjithë fëmijët prej 0-3 vjeç të vendosen në përkujdesje familjare, me disa përjashtime; për shembull kur foshnja është anëtare e një grupi të madh vëllezërisht e motrash.*

* 'SOS Kosova 'Shtëpitë e foshnjave' janë një përpjekje e mirë e përkohshme, dhe nuk duhet krahasuar me disa 'shtëpi për foshnja' në disa vende në rajon që janë shumë të mëdha e që kanë mungesë të madhe të stafit. SOS Kosova i pranon dobësitë e modelit të 'Shtëpisë Tranzicionale për Foshnja' (të themeluar menjëherë pas përfundimit të konfliktit) dhe ta zëvendësojë atë me 3 'shtëpi për foshnja' në secilën nga 6 foshnja, nën përkujdesjen e një kujdestari primar (nëna e shtëpisë) të mbështetur nga 4 asistentë. Kjo është një përpjekje e denjë afat-shkurtër për ta reduktuar problemin e foshnjave për të cilat kujdesen një varg kujdestarësh gjë që ndikon në pamundësinë e lidhjeve emocionale të sigurta. Megjithatë, 'shtëpitë' e vogla 'të foshnjave' janë ende një formë e kujdesit në grup, e cila, në pothuajse çdo rast, nuk është në interesin më të mirë të fëmijëve shumë të vegjël të cilët duhet të kenë një ose dy kujdestarë parësorë (persona për t'u lidhur me ta) në shtëpitë ku ata do të jenë 'në qendër të vëmendjes' në këtë fazë vendimtare të zhvillimit të tyre.

Ka ende foshnja të porsalindura që përjetojnë qëndrime të zgjata në spital - përtej afatit 21-ditor të propozuar në protokollin Ndërministror. Duket sikur ka probleme me shërbimin e punës sociale të spitalit të Prishtinës për të kontaktuar shpejt me QPS-të përkatëse kur një foshnje identifikohet të jetë në rrezik të lartë. Kur nënat heqin dorë nga foshnjat e tyre në spital, ka vonesa në lëshimin e tyre për në strehim familjar ose në shtëpi tranzicionale për foshnjat. Drejtoresha e Departamentit të Maternitetit, Dr. Latifi, e intervistuar gjatë punës në terren për këtë raport, ka konfirmuar se ajo plotësisht mbështet nevojën për t'i lëvizur fëmijët më shpejt. Ajo dhe stafi i saj i infermierisë i kuptojnë nevojat zhvillimore të këtyre fëmijëve shumë të vegjël, dhe se interesat e tyre më të mira qëndrojnë në dërgimin e tyre në strehim familjar sa më shpejt të jetë e mundur. Ka një numër të fëmijëve që kanë peshë të ulët të lindjes, të cilët mund të kenë lindur para kohe apo vuajnë nga një shumëllojshmëri e gjendjeve mjekësore. Këta mund të kenë nevojë për një qëndrim pak më të gjatë në spital sesa fëmijët e rëndomtë, por shumica e foshnjave nuk janë në këto kategori. AiBi ka sugjeruar që ka nevojë për një rregullore që i lejon autoritetet t'i vendosin fëmijët nga të cilët kanë hequr dorë drejtpërdrejtë nga spitali tek prindërit e ardhshëm birësues. Natyrisht që birësimi do të konfirmohet pas proceseve normale ligjore.

Disa QPS duket sikur nuk angazhohen me shpejtësinë e nevojshme që të përpiqen të parandalojnë braktisjen, dhe janë të kënaqur me vendosjen e fëmijëve në shtëpinë tranzicionale për fëmijë. Ndërkohë, ka strehues familjarë që janë duke pritur për fëmijë dhe përsëri foshnjat nuk vendosen tek ata. Janë të nevojshme veprime të mëtejshme për ta përmirësuar këtë situatë, dhe duhet të jetë relativisht e thjeshtë për ta arritur këtë, duke pasur parasysh se ekziston një mirëkuptim i përbashkët në mes të zyrtarëve të lartë në qeveri, spitalit. Disa QPS të cilat janë duke ndërhyrë shpejt dhe në mënyrë të duhur; ose punojnë në parandalimin e braktisjes ose i vendosin shpejt fëmijët tek strehuesit familjarë.

Duket sikur ndryshimet janë të nevojshme në dy pika të veçanta të sistemit, së pari shërbimet e punës sociale të Spitalit duhet të punojnë më shumë në mënyrë proaktive që t'i angazhojnë QPS-të që të punojnë me nënat 'në rrezik' dhe të përpiqen të parandalojnë braktisjen, dhe së dyti QPS-të dhe Paneli për Vendosje duhet të jenë shumë më proaktiv në vendosjen e më shumë foshnjave tek familjet strehuese.

F.5. Udhëzimi i Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale

F.5.1. Shqyrtimi i Udhëzimit

Një dokument kyç i cili e ka definuar strehimin familjar në Kosovë dhe i ka përcaktuar procedurat për vendosjen e fëmijëve në përkujdesje, është 'Manuali i Procedurave për vendosjen e fëmijëve në kujdes alternativ', të miratuar nga DPS&F në Ministri në vitin 2002. Ky manual vazhdon të jetë një dokument themelor i rëndësishëm që përshkruan parimet dhe procedurat për QPS-të. Ai është zhvilluar për Ministrinë me ndihmën e ekspertizës nga jashtë të ofruar nga UNICEF Kosovë dhe OJQ-ja ndërkombëtare EveryChild. Ai thekson idenë që strehimi familjar ka për qëllim të jetë afat-shkurtër, në pritje të një vendosjeje të përhershme tek familjet biologjike apo birësuese. Kjo është mjaft e rëndësishme, por nuk i adreson të gjitha realitetet. Disa fëmijë nuk janë në gjendje të kthehen tek familjet e tyre biologjike, kështu që strehimi familjar afatgjatë duhet të përfshihet si një alternativë e vlefshme kur të gjitha përpjekjet për ri-integrim janë të pasuksesshme, dhe birësimi nuk është në dispozicion. Disa fëmijë me aftësi të kufizuara mund të kenë nevojë për lloje të ndryshme të strehimit familjar; disa fëmijë mund të kenë nevojë për një përkujdesje të përkohshme afatshkurtër me qëllim që ti japin pushim vetes dhe familjeve strehuese, ndërsa disa fëmijë tjerë me aftësi të kufizuara mund të kenë nevojë për strehim familjar afatgjatë. Disa aspekte të përkujdesjes si largimi nga kujdesi nuk adresohen fare.

Qysh nga koha kur është shkruar ky manual, shumë struktura të reja, procedura dhe pjesë të udhëzimit janë zhvilluar; më të rëndësishmet prej të cilave janë Standardet Minimale, Paneli i Vendosjes dhe decentralizimi. Mund të jetë e nevojshme për Ministrinë që të zhvillojë disa udhëzime dhe procedura gjithëpërfshirëse në lidhje me atë se si duhet të funksionojë sistemi i kujdesit alternativ, duke i përfshirë përkufizimet e rishikuara të një game të tërë të vendosjeve në përkujdesje, dhe llojeve të strehimit familjar aktualisht në dispozicion.

F.5.2. Standardet Minimale për shërbimet Sociale (strukture dhe funksionale)

Si pjesë e mbështetjes së saj për komunat, Ministria ka mbështetur zhvillimin e një numri të madh të Standardeve Minimale për shërbimet sociale. Këto standarde janë hartuar në konsultim me QPS-të dhe mbulojnë shumë nga fushat kryesore të praktikës së punës sociale; ku shumica prej tyre merren me çështjet e mbrojtjes së fëmijëve. Ekziston një total prej 15 standardeve që janë zhvilluar që nga viti 2010, ku më të fundit janë ato për strehimin familjar dhe strehimin tek farefisi .

Standardet janë të organizuara në dimensione strukturale dhe funksionale dhe fushat kryesore të punës janë të ndara në një varg detyrash. Standardet gjithashtu janë shkruar në një mënyrë që do ta mbështesin monitorimin, dhe nuk ka dyshim se këto japin udhëzime shumë të vlefshme për punëtorët socialë në QPS. Gjithashtu është shumë e rëndësishme të përmendet që një Standard është zhvilluar për vetë strehuesit familjarë, dhe kjo po ashtu duhet të jetë një mjet shumë i vlefshëm referimi për ta dhe për t'i inkurajuar ata që të shohin veten duke vepruar në një partneritet profesional me punëtorët socialë. Si pjesë e procesit të zhvillimit dhe pilotimit të standardeve për strehim familjar dhe strehim tek farefisi janë përfshirë edhe trajnimet dhe mbështetja për implementim në dy komuna; Gjakovë dhe Ferizaj. Ministria mund të ketë nevojë të marrë parasysh ofrimin e disa punëtorive dhe trajnimeve për të gjitha Qendrat në mënyrë që të krijojë ndikim më të madh.

G. Rekomandimet

G. 1. Liderhipi

Ministria duhet ta demonstrojë liderhipin e saj të sektorit duke i bërë publike angazhimet dhe duke ndërmarrë një program të punës i cili i përfshin si në vijim:

- për të shtuar ‘pronësinë’ e tyre dhe financimin e kujdesit alternativ për një periudhë afat-shkurtër dhe afat-mesme
- për të shqyrtuar strategjinë dhe udhëzimet e tyre që lidhen me kujdesin alternativ
- organizimi i një konference qendrore në partneritet me OJO-të dhe OSHC-të për ta përshkruar një vizion të përgjithshëm për zhvillimin e sektorit të kujdesit alternativ

Si deklaratat publike edhe indikatorët e rritjes së përgjegjësisë duhet të jenë,

- a) Alokimi i buxheteve për të gjitha QPS-të, nën kontrollin e Drejtorëve të QPS-ve.
- b) Miratimi i planeve për një rritje të qëndrueshme të buxhetit për shërbimet e kujdesit alternativ në periudhën e ardhshme 3-5 vjeçare.

Ministria duhet po ashtu të marrë parasysh nëse më shumë përparim do të mund të bëhej në strehimin familjar sikur një numri të Komunave ‘udhërrëfyese’ t’i ishte dhënë mundësia për ta zgjeruar grupin e strehuesve familjarë dhe për të vendosur forma të reja të strehimit familjar (për fëmijët më të rritur në moshë, lehtësim etj.) Këto komuna të përzgjedhura mund të veprojnë si qendra, dhe të ofrojnë vendosje të specializuara për një grup prej 4/5 komunash.

G. 2. Mbështetja për strehuesit familjarë

Mbështetja për strehuesit familjarë duhet të fuqizohet në një sërë mënyrash, pagesat për strehuesit familjarë duhet të rriten. Niveli i pagesave duhet të vendoset nga Ministria dhe të mbahet si shkallë standarde në mbarë Kosovën. Sigurimi i shërbimit mbështetës të specializuar për strehuesit familjarë duhet të vendoset në një bazë të qëndrueshme.

- a) Pagesat për strehuesit familjarë

Ministria duhet të rrisë pagesat mujore për secilin strehues familjar në një shumë bazë prej 250€, dhe të mbajë pagesën aktuale shtesë prej 100€ për fëmijët me aftësi të kufizuara. Ministria duhet të marrë parasysh ndarjen e pagesës mujore në dy komponente, në bazë të ndarjes 50/50; 1. komponenti i shpenzimeve për kujdesin për fëmijë prej 125€ për një fëmijë, dhe 2., ‘pagesa për kujdestarët’ prej 125€. Ministria duhet të angazhohet për të krijuar një sistem të pagesave të diferencuara - të komponentit të shpenzimeve të kujdesit për fëmijë – bazuar në grupet e moshave të fëmijëve. Një shembull i një sistemi të tillë të grupimit dhe pagesave mund të jetë: fëmijët e moshës 0-2 vjeç = 125€, fëmijët e moshës 3-11 vjeç, plus 25€ shtesë (150€), fëmijët e moshës 12-18 vjeç edhe 25€ të tjera (175€). Ministria duhet ta formojë një grup të qëndrueshëm (që i përfshin edhe akterët) për t’i mbajtur nivelet e pagesave të strehuesve familjarë nën shqyrtim.

b) Rimbursimi i shpenzimeve të kujdesit shëndetësor

Autoritetet e Ministrisë, përmes Kolegjiut të AKK për Kujdes Shëndetësor dhe Social duhet të mbajnë një grup punues jetëshkurtër për të implementuar një sistem të qëndrueshëm për rimbursimin e menjëhershëm (ose heqjen) të shpenzimeve shëndetësore të fëmijëve të strehuar në familje.

c) Mbështetja specialistike e familjeve strehuese

Ministria duhet të financojë një shërbim me mbështetje specialistike të strehimit familjar (së paku një pozitë me orar të plotë) nga AiBi për ta plotësuar punën e bërë nga AiBi më herët. Punëtorët social nga QPS-të duhet të jenë në gjendje të ofrojnë mbështetje për strehuesit familjarë por gjithmonë do të ketë nevojë për një mbështetje më specialistike gjersa shërbimi zhvillohet. Stafit në këtë shërbim të financuar do të përdorin një pjesë të kohës së tyre për të ofruar mbështetje për strehuesit familjarë që përballen me sfida dhe vështirësi të veçanta (në koordinim me stafin e AiBi). Ata gjithashtu do të jenë të autorizuar për të komunikuar me punonjësit socialë në QPS-të, duke i ndihmuar ata në përdorimin e trajnimit dhe mjeteve të ofruara nga projekti MAE AiBi.

G. 3. Udhëzimi i Përditësuar

Ministria duhet të marrë parasysh nxjerrjen e një udhëzimi gjithëpërfshirës në lidhje me funksionimin e sistemit të kujdesit alternativ. Ky do të marrë parasysh decentralizimin dhe Standardet Minimale si dhe rolin e Panelit të Vendosjes. Ai po ashtu duhet të tentojë të përmirësojë mirëkuptimin e shkëmbyer të fushave problematike siç janë: definimi i vendosjes në përkujdesje afatshkurtër dhe afatgjatë, krijimi i statusit ligjor për foshnjat prej të cilave kanë hequr dorë, përdorimi i strehuesve familjarë, etj. përvojën.

G. 4. QPS-të

QPS-të të angazhohen individualisht dhe kolektivisht, nëpërmjet Kolegjiut të AKK, në zbatimin e Standardeve Minimale dhe të mësuarit nga njëri tjetri, veçanërisht ato që lidhen me strehimin tek farefisi dhe strehimin familjar, (Standardet 14, 15, 15a). Kjo do të përfshijë shkëmbimin e praktikave më të mira, me një fokus të veçantë në:

- menaxhimin e rasteve
- rekrutimin e strehuesve familjarë
- puna në partneritet me të gjithë ata që ofrojnë vendosje rezidenciale dhe strehim familjar; p.sh. SOS Kosova, Shpresë dhe Shtëpi për fëmijë*, Caritas dhe strehuesit familjarë.

QPS-të duhet të mbështeten nga Ministria në këtë detyrë. Ministria duhet të marrë parasysh krijimin e grupit punues për Implementimin e Standardeve Minimale - një «grup i Kampionëve» i kryesuar nga Zyrtari i Lartë për Mbrojtjen e Fëmijëve të Braktisur, me një mandat të planifikuar prej 2 vjetësh. «Grupi i Kampionëve» do të përbëhet nga 4-8 punëtorë socialë nga QPS-të dhe 2-3 përfaqësues nga OJQ-të për të ndarë (shkëmbyer) praktikën e mira në mes të QPS-ve në 2 fusha kryesore: a) rekrutimi, përzgjedhja, trajnimi, mbështetja dhe shqyrtimi i strehuesve familjarë; b) fuqizimi i praktikës së menaxhimit të rasteve dhe puna në partneritet me kujdestarët për të gjithë fëmijët e vendosur në kujdes alternativ (rezidencial dhe strehim familjar). Ata do të mbajnë lidhje me Inspektoratin dhe do të priorizojnë ato komuna ku janë vërejtur dobësi të dukshme gjatë inspektimeve.

G. 5. Fokusi në mbështetjen e nënave të rrezikuara, reduktimin e numrit të foshnjave të braktisura dhe përmirësimin e kujdesit

Më shumë punë duhet bërë në këtë fushë, dhe atë në dy aspekte në veçanti

a) Departamenti i Maternitetit në spitalin shtetëror duhet të mbahet përgjegjës zhvillimin e një shërimi të besueshëm këshillues për nënat që ka mundësi që do të heqin dorë prej foshnjave të tyre, dhe shmangien e vonesave të panevojshme në lëshimin e fëmijëve nga spitali.

b) QPS-të, dhe Prishtina në veçanti, gjithashtu nuk janë duke ndihmuar në këtë situatë me dështimin e tyre për të rekrutuar strehues familjarë dhe pranimin e heshtur të vendosjes së fëmijëve në shtëpi tranzicionale, pavarësisht se kjo nuk është në interesin më të mirë të fëmijëve.

SOS është plotësisht e përkushtuar në mbështetjen e strehimit familjar dhe në shkrirjen e shtëpive tranzicionale. Ministria duhet t'i vë vetes një objektiv për t'i dhënë fund të gjitha referimeve në 'shtëpitë për foshnja' të SOS dhe atë brenda 3 viteve të ardhshme; duke mbyllur në mënyrë efektive një nga 3 shtëpitë e vogla për çdo vit.

Mund të ndodhë që një shtëpi të mbetet në dispozicion për disa vite si një rezervë për rastet e jashtëzakonshme, ose të adaptohet edhe më tej në një shtëpi strehuese për një numër më të vogël të fëmijëve.

Një përgjigje tjetër që mund të eksplorohet me një nga OJQ-të – në këtë rast SOS do të ishte më e kapshme, do të ishte krijimi i një shtëpie për 'nëna dhe foshnja' në shkallë të vogël dhe afatshkurtër, si një opsion për disa nëna të reja që mund të mos duan të heqin dorë nga fëmija i tyre, por të cilat nuk janë duke marrë asnjë përkrahje nga familjet e tyre të afërta.

G. 6. Përmirësimi i procesit të vendosjes së statusit ligjor të fëmijëve të braktisur

Ministria dhe Komunitat duhet të ndërmarrin një projekt për përmirësimin e cilësisë së raporteve të Gjykatave. Një mënyrë për ta arritur këtë mund të jetë përmes një programi të punëtorive të përbashkëta në mes të përfaqësuesve të Gjykatave, Panelit të Vendosjeve dhe QPS-ve. Udhëzime me shkrim dhe sugjerime për 'praktikat më të mira' mund të përfshihen në një shënim udhëzues të lëshuar pas programit të punëtorive.

G. 7. Veprime për fëmijët e larguar nga kujdesi

Duke pasur parasysh mungesën e njohjes ligjore të të drejtave dhe nevojave të të larguarve nga kujdesi, ky është një boshllëk që Ministria duhet urgjentisht ta adresojë. Për fat të mirë shembuj të praktikave të mira ekzistojnë, veçanërisht shërbimet e ofruara për ish-banorë nga OJQ-të, SOS dhe Caritas. Ministria duhet të iniciojë një grup punues ndër-institucional dhe një plan pune për të adresuar këtë fushë të praktikave; duke adresuar nevojën për ligjin dhe politikat e reja dhe shkëmbimin e praktikave të mira. Grupi Punues për shërbimet për të larguarit nga kujdesi duhet të përfshijë në anëtarësinë e saj të paktën 2 të larguar nga kujdesi (të moshës 18-25 vjeç).

G. 8. Kujdesi nga Farefisi - Cilësia e kujdesit dhe jetës familjare

Duke pasur parasysh numrin e madh të fëmijëve të vendosur nga QPS-të tek farefisi është e rëndësishme që Ministria, dhe DShMS-të, të sigurohen se të gjithë këta fëmijë janë duke marrë një kujdes dhe jetë familjare të cilësisë së mirë dhe nuk janë subjekt i përjashtimit, diskriminimit apo shfrytëzimi brenda këtyre mjediseve. Punonjësit socialë nga QPS-të bëjnë vetëm vizita të kohë pas kohshme - dhe nuk është e qartë nëse standardet minimale të miratuara së fundmi për këtë fushë do të jenë të mjaftueshme për të mbrojtur plotësisht këta fëmijë dhe të rinj potencialisht të rrezikuar. Një hulumtim sistematik me fokus tek fëmijët është i nevojshëm për të fuqizuar praktikën e mbrojtjes së fëmijëve në këtë fushë, ashtu që punonjësit socialë të kenë dëshmi për kushtet e jetesës së fëmijëve nën kujdes të farefisit.

Rekomandim:

- Ministria duhet ta kryejë një studim – të mbështetur nga Departamenti për Punë Sociale i Universitetit të Prishtinës dhe QPS-të – për të hulumtuar përvojën e vendosjes së fëmijëve tek farefisi si nga perspektiva e kujdestarëve ashtu edhe nga perspektiva e fëmijëve

Janë bërë një sërë studimesh për kujdesin (formal) farefisnor, disa edhe në vende me të ardhura të larta (del Valle et al., 2011; Farmer et al., 2013) – dhe këto hulumtime vënë në pah shumë përfitime pozitive nga vendosjet tek farefisi, por edhe probleme të mëdha të fëmijëve me nivel të ulët arsimor dhe shqetësimet rreth së ardhmes së tyre- disi e ngjashme me rezultatet për fëmijët në strehim familjar ose përkujdesje rezidenciale. Ndërkohë studimet e bëra në vendet me të ardhura të ulëta (Moby, 2011) gjithashtu tregojnë për përfitime, por edhe për rreziqe të 'mbrojtjes së fëmijëve' vis-à-vis me 'vjedhje të pronës', shfrytëzim i fëmijëve për punë dhe diskriminimin brenda-familjar - fëmijët e strehuar që shihen si me më pak vlerë se vëllezërit e motrat e familjes biologjike. Gjatë punëtorisë së validimit një përfaqësues i OJQ-së raportoi se stafi i tyre ishte përballur me raste të dyshuara për abuzim të fëmijëve nën përkujdesje nga farefisi.

Rekomandimet për UNICEF Kosovë

1. Të punohet ngushtë me Ministrinë – si në nivel politik ashtu edhe në nivel të zyrtarëve - për të siguruar angazhime për përgjegjësi të shtuar, lidhje dhe buxhete për fëmijët në kujdesin alternativ dhe QPS-të.
2. Nëse kërkohet, të mbështet punën e grupit punues («Grupi i Kampionëve») për implementimin e Standardeve Minimale, ndoshta duke financuar një post 1-2 vjeçar për të mbështetur punën e grupit, i cili i raporton Zyrtarit të Lartë dhe Kryesuesit të grupit. Ky post i përkohshëm idealisht duhet të rekrutohet brenda Kosovës; dikush me përvojë të mirë në menaxhimin e rasteve, me një përkushtim për zgjidhjen e problemeve dhe punë në partneritet me QPS-të, OJQ-të dhe kujdestarët.
3. Të udhëheqë hartimin, financimin dhe të mbështesë projektin hulumtues për kujdesin e fëmijëve nga farefisi të përshkruar me sipër në Rekomandimin 7.
4. Fëmijët e larguar nga kujdesi. Të inkurajojë Ministrinë për të inicuar një plan zhvillimor për adresimin e të drejtave dhe nevojave të fëmijëve të larguarve nga kujdesi, duke adresuar kështu një boshllëk të madh në respektimin nga ana e Kosovës të Udhëzimeve të OKB-së për Kujdesin Alternativ të Fëmijëve. Nëse kërkohet nga Ministria, t'i sigurojë sekretariatit një grup punues ndërinstitucional për zhvillimin e ligjit, politikave dhe praktikës në këtë fushë, duke përfshirë në anëtarësi të grupit përfaqësues të OJQ-ve dhe të të larguarve nga kujdesi. Të publikojë një broshurë/façe interneti që mbledh informacion në lidhje me rrethanat e atyre fëmijëve që janë larguar së fundmi nga kujdesi dhe që gjithashtu ilustron praktikën e mirë me shembuj dhe raste studimore të siguruar nga Caritas dhe SOS Kosova.

Referencat

Amici dei Bambini. (2014). Fuqizimi i shërbimeve sociale që merren me fëmijët jashtë familjes. Prishtinë: AiBi.

Cantwell, N., Davidson, J., Elsley, S., Milligan, I. & Quinn, N. (2012). Të Lëvizet Përpara: Implementimi i 'Udhëzimeve për Kujdesin Alternativ të Fëmijëve'. Mbretëria e Bashkuar: Qendra e Ekselencës për Fëmijët e Përkujdesur në Skoci.

Del Valle, J., Lazarro-Visa, S., Lopez, M. & Bravo, A. (2011). Largimi nga kujdesi familjar: tranzicionet në moshën e rritur nga kujdesi farefisnor, Shqyrtimi i Shërbimeve për Fëmijët dhe Të Rinjtë, 32, 2475-2481.

Familje për Çdo Fëmijë. (2014). Strategjitë për ofrimin e sigurt dhe efektiv të strehimit familjar. Londër: Familje për Çdo Fëmijë.

Farmer, E., Selwyn, J. & Meekings, S. (2013). 'Fëmijët tjerë thonë se ju nuk jeni normal sepse ju nuk jetoni me prindërit tuaj. Pikëpamjet e fëmijëve për jetën me kujdestarët farefisnorë joformalë: rrjetet sociale, stigma dhe lidhja emocionale me kujdestarët, Puna Sociale me Fëmijë & Familje, 18, f. 25-34.

Gashi-Rashiti, H. (2012?). DFID Programi për Decentralizimin e Shërbimeve Sociale të Kosovës - Buletini Final.

KOMF. (2014a). Më Dërgo në Shtëpi! Analizë e shkurtër e avancimit të mbrojtjes së fëmijëve të braktisur në Kosovë (0-3 vjeç). Prishtinë: KOMF

Quinn, N., Davidson, J., Milligan, I., Elsley, S. & Cantwell, N. (2014). Të Lëvizet Përpara: Drejt një paradigme të bazuar në të drejtat e të rinjve në tranzicion nga kujdesi. Puna Sociale Ndërkombëtare, Tetor 2014, online.

Roby, J. (2011). Fëmijët në kujdes alternativ joformal. Nju Jork: UNICEF.

SOS Fshatrat e Fëmijëve. (2010). Unë Jam me Rëndësi - raport i përkohshëm i vlerësimit. Innsbruck: SOS CV International.

UNICEF dhe KOMF. (2014b). A janë duke arritur paratë e tatimpaguesve tek fëmijët në nevojë? Analizë e shkurtër e buxhetit për politikën e mbrojtjes sociale për fëmijët në Kosovë. Prishtinë: KOMF.

UNICEF. (2012). Hartëzimi dhe Vlerësimi i sistemit të mbrojtjes së fëmijëve në Kosovë* (RKSOKB 1244).

Prishtinë: Mbrojtja e Fëmijëve dhe Këshilli i Drejtësisë për Fëmijë/UNICEF

UNICEF. (2014). Korniza Ligjore për të Drejtat e Fëmijëve në Kosovë: Studim mbi pajtueshmërinë e legjisllacionit në fuqi me Konventën për të Drejtat e Fëmijëve. Prishtinë. UNICEF Kosovë

Shtojcat

1. Lista e të intervistuarve për analizën e situatës së strehimit familjar në Kosovë, Shtator 2015

Emri	Roli	Organizata
Z. Afrim Ibrahim	Shef i sektorit për mbrojtje të fëmijëve	UNICEF
Znj. Feride Dashi	Zyrtare për mbrojtje të fëmijëve	UNICEF
Z. Bajram Kelmendi	Shef i Departamentit për Politika Sociale dhe Familje	MPMS
Znj. Magbule Koci	Zyrtare e Lartë për Mbrojtjen e Fëmijëve të Braktisur	MPMS
Z. Vebi Mujku	Drejtor i Qendrës për Punë Sociale	QPS Prishtinë
Znj. Ibadete Krasniqi	Drejtor Kombëtar	OJQ-ja Italiane 'Amici dei Bambini'- partner implementues i Ministrisë për strehimin familjar
Znj. Donjeta Kelmendi	Drejtor Ekzekutiv	KOMF – Koalicioni i OJQ-ve për mbrojtjen e fëmijëve
Znj. Valbona Çitaku	Drejtor	Shpresa dhe Shtëpitë për fëmijë Kosovë
Znj. Ora Bytyqi	Drejtor i Programit të SOS Fshatit të Fëmijëve, Prishtinë	SOS Kosova
Znj. Blerta Perolli Shehu	Drejtor, SOS Zhvillimi i Programit Kombëtar	SOS Kosova
Z. Gani Lluga	Konsulent i pavarur dhe Drejtor	ASTRA, OJQ lokale për hulumtimin dhe vlerësimin e shërbimeve sociale
Dr. Mynevere Latifi	Drejtor	Reparti i Gjinekologjisë, Spitali i Prishtinës
Z. Gjon Luli	Drejtor (edhe punonjës social)	QPS Gjakovë
Z. Mursel Zymeri	Drejtor (edhe punonjës social)	QPS Gjilan
Z. Blerim Begaj	Director	QPS e Malishevës

Emri	Roli	Organizata
Lushe e Mark Vorfi Shkurte e Tun Hajdaraj Zoje Tunaj Pashke e Sarafin Lasku Miradie e Musë Krasniqi Bora e Zef Dedaj Vera e Kelmend Ndrecaj	7 Familje strehuese nga Gjakova	QPS e Gjakovës
Alije e Aziz Hamdiu Hakile e Kujtesa Lutfiu	2 Familje strehuese nga Gjilani	QPS e Gjilanit
Z. Aziz Hamdiu	Drejtor	Shoqata e Strehuesve Familjarë
Z. Massimo Mazzali	Drejtor, shtëpia e fëmijëve e Caritas-it, Zllakuqan, Klinë	Caritas, Urbani (Itali)

2. Dokumentet e konsultuara gjatë shqyrtimit në zyrë dhe vizitave në terren

	Titulli	Autori	Data
1	Një Pasqyrë e aranzhimeve të Kujdesit Alternativ në Kosovë	SOS Kosova	2013
2	A janë duke arritur paratë e tatimpaguesve tek fëmijët në nevojë? Analizë e shkurtër e buxhetit për politikën e mbrojtjes sociale për fëmijët në Kosovë.	UNICEF dhe KOMF Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve	Prill 2014
3	Shërbimet sociale në Kosovë: Vlerësimi Ligjor dhe i Buxhetit.	Save the Children Aleanca në Kosovë	Gusht 2007
4	Zhvillimi i Strehimit Familjar në Kosovë: analizë e situatës	Peter Evans EveryChild	Shkurt 2004
5	Zhvillimi strategjik në edukimin për punë sociale në Kosovë: Ndërtimi i një profesioni me vlerë	Anne Hollows UNICEF/ADA/WUS	Nuk ka date 2014/15
6	Më Ço në Shtëpi! Analizë e shkurtër e avancimit të mbrojtjes së fëmijëve të braktisur në Kosovë (0-3 vjeç)	KOMF	Prill 2014
7	Udhëzimi Administrativ Nr 05/2006 Për Themelimin e Panelit për Vendosjen e Fëmijëve pa kujdes prindëror në Strehim familjar dhe Birësim	Udhëzimi Statutor i MPMS sipas Ligjit për Shërbimet Sociale dhe Familjare 2004/2011	2006
8	Sistemi për mbrojtjen e fëmijëve pa kujdes prindëror në Kosovë ('Projekti MAE AIBI')	AiBi – Amici dei Bambini Italian NGO	Nuk ka date 2013/4
9	Strategjia e punës së Kolegjiumit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale për vitet 2014 – 2016	Asociacioni i Komunave të Kosovës	Shtator 2013
10	DFID Programi për Decentralizimin e Shërbimeve Sociale të Kosovës - Buletini Final.	DFID Decentralizimi i Shërbimeve Sociale të Kosovës Hyriji Gashi-Rashiti	2012
11	Udhëzimi Administrativ Nr. 16/2009 Për ndryshimin dhe plotësimin e Nr. 16/2004 për rregullimin e Strehimit - Autorizimi i pagesave prej € 150 pfm për 'familjet pritëse'	Qeveria e Kosovës, MPMS	2009

	Titulli	Autori	Data
12	Korniza Ligjore për Të Drejtat e Fëmijëve në Kosovë: Një studim i pajtueshmërisë së legjislacionit ekzistues me Konventën për të Drejtat e Fëmijëve	UNICEF Dan O'Donnell	Prill 2014
13	Hartëzimi dhe vlerësimi I i sistemit të mbrojtjes së fëmijëve në Kosovë* (RK-SOKB 1244)	Mbrojtja e fëmijëve dhe Këshilli i Drejtësisë për Fëmijë & UNICEF	2012
14	Ligji Nr. 04/L-081 Për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-17 Për Shërbimet Sociale dhe Familjare	Qeveria	Prill 2012
15	Procedurat udhëzuese për birësimin e fëmijëve pa kujdes prindëror	Qeveria	
16	Standardet Minimale 14 & 15 – strehimi familjar	MPMS, Qeveria	2014
17	Zhvillimi i Standardeve Minimale – Raporti përfundimtar	ASTRA & UNICEF	Dhjetor 2014
18	Manuali i procedurave për vendosjen e fëmijëve në kujdes alternativ	MPMS, Qeveria	2002

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

364(496.51)“2015”

Fuqizimi i kujdesit të bazuar në familje, fuqizimi i punës sociale :
një analizë së strehimit familjar në Kosovë 2015 / Jan Milligan. Prishtinë:
UNICEF, 2016. - 46 f. : ilustr. ;

Parathënie : f. 1. – Referencat : f. 42

1. Jan Milligan

ISBN 978-9951-601-14-6